

# PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri V, viti 2001

	Faqe
Opinione mbi politikat ligjore:	3
Diskutime në Kuvendin e Shqipërisë mbi luftën kundër terrorizmit	
- Nga fjala e deputetit Fatmir Xhafa, Partia Socialiste	5
- Nga fjala e deputetit Dashamir Shehi, Partia Demokratike ( R)	9
- Nga fjala e deputetit Prec Zogaj, Partia Aleanca Demokratike	12
Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë për luftën kundër terrorizmit	15
E Drejta Parlamentare:	
Roli i legjislativit në çështjet kombëtare të sigurimit ,	
David GREENWOOD	17
Komisionet Parlamentare të Hetimit: instrumente të rëndësishme kontrolli,	
Sokol BERBERI	36
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend, Filip LAKO	47
Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare,	
- Dokumentacioni ligjor mbi luftën kundër terrorizmit,	
përgatiti Elira ZAKA	57
- Zgjedhjet parlamentare në Kosovë dhe korniza kushtetuese,	
përgatiti Leon SHESTANI	62
Veprimtari të Qendrës Studimore mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokratike,	
Elira ZAKA	65
Përmbledhje e përkthyer në anglisht:	
Opinione mbi Politikën Ligjore	69
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	78



*Kjo rubrikë synon paraqitjen e politikave ligjore, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Publiku dhe subjektet e interesuara duhet të jenë të qartë për debatin politik dhe për qëndrimet e forcave të ndryshme politike për çështje të rëndesishme që prekin interesa të një kategorie të gjerë njerëzish.*

*Në këtë numër të revistës janë pasqyruar diskutime të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, për luftën kundër terrorizmit.*



# Diskutime në Parlamentin e Shqipërisë mbi çështjen e luftës kundër terrorizmit

*Nga fjala e deputetit  
Fatmir Xhafaj, mbajtur në seancën  
plenare të datës 26 shtator 2001*

*I nderuar zoti Kryetar, të nderuar kolegë,*

Para së gjithash, e gjej të arsyeshme të shpreh konsideratat e mia pozitive për iniciuesit e këtij debati, tema e të cilit në thelb shpreh edhe qëndrimin e njësuar të të gjithë shqiptarëve, kudo që ata jetojnë.

Akti i 11 shtatorit ishte i dhimbshëm për pasojat që shkaktoi, për jetët e njerëzve të pafajshëm që ndërpreu, për dëmet e shumta që solli, por njëherësh dhe në thelbin e tij ai ishte një goditje që synoi lëkundjen e sistemit të vlerave njerëzore, të sistemeve bashkëkohore të sigurisë kombëtare, duke goditur kështu jo thjesht vetëm Amerikën, si vendin ku vlerat njerëzore dhe qytetare janë institucionet morale dhe ligjore më të rëndësishme, por çdo vend në botë që u bashkohet vlerave të qytetërimit dhe të lirisë.

Ne, shqiptarët, krahas parimeve humane universale, kemi edhe arsye e ndjeshmëri të veçantë, që na bëjnë të bashkohemi aktivisht me dhembjen amerikane, të mbështesim pa asnjë rezervë qëndrimet e Qeverisë Amerikane dhe angazhimin e saj në këtë luftë të re të sapofilluar.

Goditjet e terroristëve kundër simbolit të paqes, harmonisë, zhvillimit dhe demokracisë janë goditje që synojnë rrëzimin e ëndrrës së shqiptarëve

ndaj këtij simboli. SHBA janë sot, veç të tjerash, shteti më i angazhuar me shqiptarët, shteti më mbështetës dhe më i pranishëm në botën tonë problematike dhe plot shqetësime. Amerikanët janë në anën e shqiptarëve si asnjëherë tjetër në historinë tonë, ndaj dhe sulmet ndaj tyre janë jo vetëm kundër interesave amerikane, por edhe kundër interesave thelbësore të shqiptarëve, interesat e të cilëve prej shumë vitesh janë të njësuara me interesat e amerikanëve; ato sulme janë kundër shpresave për një jetë më të mirë të shqiptarëve kudo që janë.

Jam në një mendje me opinionin e shfaqur se, para se të jetë një betejë ushtarake, ajo është dhe mbetet një luftë ndërmjet lirisë dhe frikës, ndërmjet dhunës dhe paqes, tolerancës dhe intolerancës, ndërmjet drejtësisë dhe kimit. Është ky këndvështrim që i jep kësaj lufte përmasa globale, shtrirje kohore afatgjatë dhe domosdoshmërinë e një koalicioni të gjerë, duke parë, si angazhimet globale e rajonale, ashtu dhe përgjegjësitë dhe angazhimet kombëtare brenda çdo vendi.

Ne, edhe në këtë rast, duhet të përfitojmë nga përvoja dhe vlerat e politikës dhe të lidërshiptit amerikan. Ne pamë një Kongres plotësisht të angazhuar e të njësuar në qëndrimet mbështetëse ndaj Presidentit Bush dhe në tërësi në përballimin e situatës së krijuar. Pamë një lidërshipt që t'i drejtohej me të njëjtën mirënjohje për mbështetjen e dhënë si pozitës, ashtu edhe opozitës. Ndërsa në vendin tonë edhe ceremonia përkujtimore për viktimat e 11 shtatorit u zhvillua në dy kampe dhe në dy kohë. Jo rrallë kemi parë të fqinja jonë Italia ose në Spanjë, si një nga vendet me të prekura nga aktet terroriste, të organizohen shpesh manifestime antiterroriste dhe pikërisht në të tilla veprimtari janë shfaqur së bashku të majtë dhe të djathtë për të dhënë së bashku të njëjtin mesazh human e politik: Ne jemi njësoj të distancuar nga aktet kriminale të terrorit, ne kemi të njëjtin qëndrim ndaj terroristëve dhe jemi njësoj të vendosur për t'i luftuar ata.

Është një rast tjetër i mirë që Qeveria, në procesin e platformës antiterror dhe antikrim që po harton, të kërkojë edhe angazhimin konstruktiv

të asaj pjese të opozitës që është jashtë strukturave parlamentare, ashtu siç shpresoj se kjo e fundit do të ketë mundësinë më të mirë të tregojë përgjegjshmërinë politike e morale për t'iu përgjigjur pozitivisht, për të rivendosur urat e bashkëpunimit institucional për çështjet madhore që preokupojnë opinionin dhe të ardhmen e vendit, mundësinë që të tregojë se politika shqiptare, në të gjithë harkun e saj, është futur në rrugën e civilizimit dhe nuk është shtrat ku të gjejë strehë justifikimi i dhunës dhe i intolerancës dhe, pse jo, edhe frymëmarrja e mbështetja për disa elementë të inkrimuar.

Aktet terroriste të 11 shtatorit, jo vetëm në Amerikë, por edhe në shumë vende të botës janë duke shërbyer si një nxitës i fuqishëm për të riparë e rivlerësuar më mirë kuadrin ligjor, strukturat, mekanizmat dhe masat e sigurisë kombëtare të çdo vendi.

Pajtohem plotësisht me përfundimin se është e vërtetë që në Shqipëri nuk ka elementë, grupe ose baza terroriste në kuptimin e dukurisë që është aktualizuar, por gjykoj se duhet të pranojmë që kemi pasur dhe kemi ende raste lokale të ngjarjeve kriminale, si ato të hedhjes në erë të shtyllave elektrike ose depove të ujësjellësve, akte këto që, pavarësisht natyrës dhe qëllimit të tyre, kanë natyrën e akteve terroriste, trajtimi dhe goditja ndaj të cilave s'ka pse të lidhet me interesat politike të ditës.

E gjykoj plotësisht të drejtë vlerësimin se në luftën kundër terrorizmit rëndësi të posaçme ka lufta kundër elementëve mbështetës, siç është krimi në tërësi dhe krimi i organizuar në veçanti. Nuk është rastësi fakti i njohur që pjesë të strukturave kriminale të “Al Kaedas” janë të njohura për veprimtarinë e tyre në tregun ndërkombëtar.

Presidenti Bush, në fjalën e tij në Kongresin Amerikan, ndërmjet të tjerash, theksoi se “Al Kaeda” ka lidhje me terrorizmin, ashtu si edhe mafia ka lidhje me krimin”, sepse, ndërmjet të tjerash, kanë të përbashkët faktin se “këta terroristë nuk marrin thjesht jetë njerëzish, por synojnë të shkatërrojnë një mënyrë jetese”, parimet dhe institucionet e lirisë dhe të drejtësisë.

Konventat e OKB-së sigurojnë një kornizë të mirë ligjore për shumë hapa që do të ndërmerren për të luftuar terrorizmin, përfshirë ekstradimin dhe dënimin e kriminelëve dhe bllokimin e parave të pista, ndaj dhe aderimi i vendit tonë në to me të drejtë është konsideruar parësor nga strukturat tona shtetërore, por gjykoj se po aq i rëndësishëm është implementimi i tyre në një sërë kodesh dhe ligjesh të tjera që operojnë në këto fusha. Flasin për bashkëpunim me strukturat homologe në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar dhe ende kemi mangësi të ndjeshme në dispozitat që rregullojnë këto marrëdhënie, aq sa kemi aktualisht një dukuri shqetësuese, që disa kriminelë të njohur dhe të dënuar për krime të rënda nga gjykatat e vendeve europiane - anëtare të atij bashkimi ku ne duam të integrohemi - rrinë të qetë dhe shëtisin lirisht në rrugët e Shqipërisë, thjesht dhe vetëm sepse ne kemi hequr dispozitën përkatëse nga Kodi i Procedurës Penale.

E konsideroj normale nevojën për rishikimin rrënjësor të kuadrit ligjor dhe ndryshimet që duhen bërë në statusin e strukturave ekzistuese që operojnë në këto fusha, por personalisht gjykoj se në kushtet e vendit tonë nuk është e domosdoshme dhe e justifikuar ngritja e strukturave të reja. Imitet në raste të tilla nuk janë fort të dobishme, përkundër nevojës për një implementim më të mirë dhe më të shpejtë të legjislacionit bashkëkohor, aftësimin profesional, më të mirë të strukturave ekzistuese dhe bashkërendimit të marrëdhënieve institucionale ndërmjet tyre.

Jam plotësisht dakord me qëndrimin e shprehur se ka ardhur koha për hapa konkretë, për sfidat e reja në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilët, nëse nuk luftohen që në embrion, mund të kthehen në një problem të madh për sigurinë kombëtare të vendit dhe për të ardhmen e tij.

Në këtë kontekst e gjykoj të dobishëm dhe me interes zhvillimin e këtij debati parlamentar, që do të ndikojë drejtpërsëdrejti në angazhimin më aktiv dhe më efektiv të shtetit shqiptar, si pjesëtar i aleancës së gjerë kundër terrorizmit ndërkombëtar.



*Nga fjala e deputetit  
Dashamir Shehi, mbajtur në seancën  
plenare të datës 26 shtator 2001*

I nderuar zoti Kryetar, të nderuar kolegë,

Unë mendoj që debati i sotëm kundër terrorizmit mund të ishte bërë edhe më përpara, ndoshta një javë ose dhjetë ditë më parë, megjithatë, unë e quaj një lloj sukcesi të këtij Kuvendi që pas shumë kohësh po bëjmë një seancë të përbashkët të Kuvendit me Qeverinë, sepse rëndësia e temës është pikërisht e tillë, që realisht ka nevojë për ndihmesën dhe mbështetjen e të gjitha forcave institucionale që operojnë sot në Shqipëri.

T'i rikthehemi luftës kundër terrorizmit dhe rëndësisë së saj, mua më duket një temë relativisht e tejkaluar, sepse gjatë gjithë këtyre dy javëve vetëm praktikisht është diskutuar për këtë temë. Unë do të thosha, cili është roli i partive politike, roli i politikës, i Kuvendit dhe i institucioneve të ndryshme brenda këtij konteksti?

Fatkeqësisht, që në fillim të procesit të ngjarjeve të 11 shtatorit në Nju Jork, pamë që në Shqipëri kishte një lloj kënaqësie të disa lloj grupeve, personave dhe forcave që Shqipëria na paskësh qenë pak e infektuar nga elementet e islamizmit dhe kjo vinte nga pjesa opozitare, e cila kënaqej, në një farë mënyre, me idenë që përpara viteve '96 paskësh qenë një grup tjetër në Qeveri dhe mendonte që do ta dëmtonte atë grup. Nuk është e

vërtetë. Unë ju garantoj si pjesëtar i asaj qeverisjeje të asaj kohe, që dhe në atë kohë nuk ka pasur ndonjë dëshirë të madhe përsa u përket këtyre çështjeve, por do të thosha që entuziazmi i disa grupeve nuk bën gjë tjetër veçse i bën dëm të madh Shqipërisë. Ta ngjyrosësh Shqipërinë me ngjyra islamike, sikur ka qenë mbështetësja, baza e terroristëve, sepse disa elementë kanë qenë këtu, unë besoj se ka qenë shumë e gabuar, siç shoh shumë të gabuar edhe dëshirën e opozitës, një pjese të opozitës shqiptare sot, që të mendojë që Shqipëria është vendi i trafiqeve, i drogës dhe i krimit të organizuar. Nuk është e vërtetë; edhe ne duhet të mësojmë nga kjo fatkeqësi botërore, por ndoshta, pjesërisht edhe për Shqipërinë, që nuk kemi nevojë pse t'i vëmë një shtresë balte vendit tonë, sepse ka mjaft probleme dhe besoj se asnjë nga këta elementë, qoftë nga njëra palë, qoftë nga ana tjetër, nuk e ndihmojnë Shqipërinë për të ecur përpara.

Këtu dëgjuam nga zoti Kryeministër dhe Ministri i Mbrojtjes që janë marrë një sërë masash përsa i përket mbrojtjes kundër terrorizmit, problemeve të natyrës ushtarake të sigurimit, problemeve të çështjeve administrative të ekzekutivit, unë do të thosha që ne si Kuvend, përtej këtij detyrimi që kemi, që është në radhë të parë i Qeverisë, kemi një detyrim tjetër: të japim një sinjal të qartë politik, përfundimtar, që ne jemi të rreshtuar me të gjitha mjetet dhe mundësitë tona, që ndoshta mund të mos na kërkohen kurrë, në rreshtin perëndimor proatlantik, pro Shteteve të Bashkuara. Në radhë të parë, sepse kemi një detyrim shumë të madh moral, sidomos pas ngjarjeve të fundit në Kosovë dhe në Maqedoni, në të cilat i gjithë opinioni perëndimor dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë ndodhur në rrjesht të parë në favorin tonë. Kjo është e para, pra, niveli pragmatist i politikës. Në radhë të dytë, kemi detyrimin si një demokraci e re, sado e paevoluar shumë, që të mbajmë në mënyrë të hapur orientimin properëndimor, pavarësisht sesi do të rrjedhin ngjarjet e mëtejshme. E treta, ne kemi për detyrë që t'i qartësojmë botës se Shqipëria, në fund të fundit, është një vend laik. Ne nuk kemi qenë kurrë, një vend fetar. Realiteti shqiptar është ky: ne jemi një

vend laik, në të cilin feja relativisht ka shumë pak ndikim, kështu që nuk mund ta ngjyrosësh Shqipërinë me ngjyra të ndryshme fetare. Ndërkohë, ne mendojmë që sot, e gjithë bota perëndimore dhe e gjithë bota në përgjithësi ka nevojë për shtete të emancipuara politikisht dhe nga ana fetare. Shqipëria, fatmirësisht, me gjithë njëmijë problemet që ka pasur, ka një mendësi shumë të emancipuar laike, që mund të jetë një model shumë i madh për shumë nga vendet që sot vuajnë nga një ndikim i caktuar fetar dhe kjo është një pasuri që na e ka dhuruar historia jonë e vjetër, të cilën duhet ta ruajmë, ta pasurojmë dhe ta bëjmë me të vërtetë model. Në fund të fundit, pas shumë vjetësh, ka ardhur dita që edhe Shqipëria të ofrojë diçka relativisht të vlefshme për bashkësinë ndërkombëtare dhe unë besoj që kjo është një pasuri që ne do ta mbrojmë të gjithë bashkërisht dhe do ta vlerësojmë në tregun ndërkombëtar politik. E them këtë, sepse sido që të jenë masat tona të natyrës së mbrojtjes, të teknikave operative të sigurimit, të njëmijë masave kundër elementëve terroristë, sidoqoftë, ne mbetemi përsëri një vend prapa perëndimit përse i përket kësaj çështjeje. Mbetemi prapa përse i përket teknikës dhe mjeteve që kemi, por sigurisht jemi më të gatshëm t'i afrojmë botës perëndimore, edhe botës që sot ka probleme, modelin tonë të bashkekzistencës midis bashkësive të ndryshme fetare dhe një paqe që nuk është e këtyre ditëve, po është shekullore. Besoj se ky do të jetë realisht një sinjal që do t'i vlejë luftës kundër terrorizmit, do të jetë edhe një shans për emancipimin politik të Shqipërisë në bashkësinë ndërkombëtare.

*Ju faleminderit!*

*Nga fjala e deputetit  
Preç Zogaj, mbajtur në seancën  
plenare të datës 26 shtator 2001*

Sot kemi rastin të shprehim krenarinë tonë për faktin që Shqipëria është rreshtuar në frontin e madh antiterrorist të planetit. Unë përshëndes qëndrimet dhe masat e Qeverisë, duke i ofruar të gjithë mbështetjen time si deputet në këtë sfidë të jashtëzakonshme. Sipas mendimit tim, janë shumë të mira masat e propozuara, për të bërë që Shqipëria të jetë një vend ku nuk mund të kalojnë terroristët, ku nuk mund të stacionohen ose të fshihen terroristët, ku nuk mund të ruhen ose të trafikohen kapitale që shërbejnë për të financuar krimet makabre të terroristëve në Europë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kudo tjetër.

Pa nënvlerësuar aspak rreziqet e mundshme edhe për territorin tonë, se duhet ta themi, zoti Kryetar, që Shqipëria nuk është në top-listën e vendeve ku synon të godasë terrorizmi, por angazhimet e saj në këtë luftë duhet të mbështeten e të pasqyrojnë një koncept edhe më global për shkaqet dhe synimet e terrorizmit ndërkombëtar, si një dukuri përçudnuese e epokës që jetojmë. Duke marrë në konsideratë masat e propozuara në projektin e shpërndarë këtu në sallë, do të thoja që në këtë projekt mund të gjejnë shprehje edhe angazhime të tjera që lidhen pikërisht me një koncept më global për shkaqet dhe synimet e terrorizmit.

Konkretisht mendoj që Shqipëria duhet ta thotë më me forcë fjalën e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në forumet perëndimore për zbutjen e kontrasteve të mëdha të zhvillimit në botë, për luftën kundër varfërisë dhe injorancës, sepse, ndër të tjera, këto janë dukuri që ose ushqejnë terrorizmin, ose shfrytëzohen nga elementët e luftës për qëllimet e tyre kriminale. Së dyti, mendoj se Shqipëria, për vetë veçoritë e saj, ku diversiteti fetar përbën një avantazh shumë të madh, ka mundësi të luajë një rol më aktiv, më konstruktiv për paqen në rajon e në Mesdhe, përfshirë Lindjen e Mesme.

Zoti Kryetar, qëllimi i vërtetë i terrorizmit nuk është çështja palestineze ose çështja arabo-islamike, siç pretendojnë njerëzit e Bin Ladenit dhe Bin Ladeni vetë. Shënjestra e vërtetë e terrorizmit është liria dhe demokracia, janë shoqëritë dhe shtetet ku pushteti buron nga vota e lirë e qytetarëve dhe ku të drejtat universale janë të shenjta. “Terrorizmi është armiku i secilit prej jush” u tha Presidenti Xhorxh Bush kongresmenëve amerikanë, të zgjedhur me vota të lira, ditën kur u paraqit përpara tyre. Dhe ne mund të themi se terrorizmi është vërtet armiku i të gjithë njerëzve që zgjidhen me vota të lira, është armiku i të gjitha demokracive në botë. Mendoj se ne do ta mundim terrorizmin, duke mbrojtur dhe zhvilluar vazhdimisht vlerat e lirisë dhe të demokracisë, shtetin e së drejtës, zgjedhjet e lira dhe kështu me radhë.

Mendoj se askush nuk duhet të ketë iluzionin se terrorizmi mund të shërbejë si një alibi për ngushtimin e hapësirave demokratike dhe forcimin e arbitraritetit. Në këtë kuadër, unë mendoj se është e domosdoshme që të punohet më shumë për ngritjen e nivelit profesional, veçanërisht të policisë, të punonjësve të SHISH-it, të Prokurorisë e të gjykatave, për të dalluar qartë kufirin midis veprimtarisë terroriste, në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale, dhe veprimtarive keqbërëse ose veprave penale rutinë.

Njëherësh mendoj se nuk është e tepërt të apelojmë një kujdes maksimal përsa i përket qëndrimit ndaj shtetasve të huaj me origjinë nga

vendet islamike, që janë përkohësisht në Shqipëri, duke dalluar qartë kufirin midis atyre që janë implikuar ose ka fakte e informacione se përbëjnë një kontigjent për terrorizmin, me ata që kanë ardhur në Shqipëri si të tërë qytetarët e tjerë të botës, që dëshirojnë të kalojnë disa ditë në atdheun tonë.

*Ju faleminderit!*



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

*Tiranë, më 26 shtator 2001*

### REZOLUTË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pas tragjedisë së shkaktuar si rrjedhojë e sulmeve terroriste mbi New York dhe Uashington D.C. më 11 shtator 2001, si edhe duke vlerësuar ndikimet e mundshme mbi rendin dhe sigurinë globale:

1. Ndan dhembjen dhe shpreh solidaritetin më të thellë me popullin amerikan dhe familjet e viktimave.

2. Dënon ashpërsisht këto akte terroriste barbare të kryera mbi civilë të pafajshëm dhe simbolet e demokracisë dhe i konsideron ato dhunim flagrant të të drejtës më themelore të individit, të drejtën për jetën, si dhe i cilëson ato si një agresion kundër vlerave të lirisë dhe demokracisë në botë.

3. Shpreh gatishmërinë dhe vendosmërinë për të mbështetur dhe bashkëpunuar me Qeverinë e SHBA-së dhe aleancën e vendeve demokratike në luftë kundër terrorizmit për të nxjerrë përpara drejtësisë e për të ndëshkuar përgjegjësitë e këtyre krimeve të përbindshme, si dhe për të çrrënjësuar shkaqet e tyre.

4. Vlerëson se ky lloj terrorizmi, që nuk njeh kufij, duhet të neutralizohet mbi bazën e një zgjidhjeje komplekse globale, politike, institucionale etj. dhe të krijimit të një koalicioni ndërkombëtar efikas për këtë qëllim.

5. Konsideron se akte të tilla terroriste frymëzohen nga grupe të caktuara ekstremiste, të cilat përmes një shtrembërimi të qëllimshëm të parimeve fetare për justifikimin e dhunës, synojnë të provokojnë një përplasje midis Perëndimit dhe Botës Islamike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nisur nga angazhimet që burojnë nga anëtarësia e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë, dypalëshe dhe me organizmat euroatlantike e të sigurisë rajonale, i kërkon Qeverisë Shqiptare të intensifitojë përpjekjet për bashkërendimin e veprimeve të të gjitha institucioneve të shtetit në luftën kundër veprimeve terroriste, krimet të organizuar dhe të gjitha llojeve të trafiqeve.

Në këtë kuadër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Qeverinë:

- Të rishikojë të gjithë kuadrin ligjor ekzistues kundër akteve terroriste, me synim parandalimin dhe goditjen e fuqishme të terrorizmit.

- Të ndërmarrë të gjitha veprimet për plotsësimin e procedurës së nevojshme për ratifikimin e konventave antiterroriste ekzistuese dhe, në mënyrë të veçantë, Statutin e Romës mbi Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për Goditjen e Financimeve të Terrorizmit.

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të monitorojë përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga të gjitha konventat ekzistuese të ratifikuara në luftën kundër terrorizmit dhe të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë drejtim, duke respektuar e zhvilluar më tej liritë dhe të drejtat e njeriut.



# Roli i legjislativit në çështjet kombëtare të sigurimit

*David Greenwood, Drejtor Kërkimor,  
Qendra Europiane për Studime mbi Sigurinë,  
artikull i përgatitur tek CEES për Programin Kontrolli  
Demokratik: Programi për Edukimin e Parlamentit dhe  
stafit parlamentar (DEMCON-SEE), që u përdor si  
material në seminarin e DEMCON-SEE, zhvilluar në  
Tiranë. Materiali u përkthye nga Elga Mitre.*

Ky artikull përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë është një koment i zgjeruar për format e ndryshme të qeverisjes që janë ushtruar ndër shekuj dhe ende përfaqësohen sot në botë. Qëllimi im është t'ju bëj të reflektoni mbi disa çështje të rëndësishme të politikës që do t'u paraprijnë diskutimeve në ditët që do të vijojnë. Veçanërisht, ju ftoj të reflektoni mbi natyrën e marrëdhënieve midis pushtetit ekzekutiv dhe popullsisë që pëson ndryshime. Kjo paraqitje na çon në konkluzione të rëndësishme për rolin thelbësor të përfaqësuesve të zgjedhur në shoqëritë demokratike.

Më pas do të vijojmë me një shqyrtim të detyrimeve bazë të ekzekutivit dhe përgjegjësitë kyçe të këtyre përfaqësuesve – ose të legjislativit – nëse natyra e atij roli është krijuar. Kjo do të jetë pika e dytë në axhenden time.

Së treti, do të përmendim institucionet dhe procedurat që duhet të vendosen në vendin e tyre, nëse ligjvënësit duhet të luajnë me efektivitet rolin e tyre. Në këtë pikë, unë do t'i kushtoj vëmendje të veçantë çështjeve kombëtare të sigurimit (të përkufizuara gjerësisht) dhe do të skicojmë një

specifikim të masave “ideale”, që mund të merren (për të cilat shumë pak demokraci të pjekura mund të krenohen). Ju mund t’ju duket e udhës të përdorni këtë specifikim si një listëkontrolli kundrejt vlerësimit të situatës në vendin tuaj (si dhe vendeve të tjera “në tranzicion” nga një rend - një parti -një shtet në një politikë pluraliste).

### I. FORMAT E QEVERISJES

Kanë qenë mendimtarët e Greqisë së Lashtë të parët që kanë sugjeruar filozofinë politike se fuqia supreme (kratos) gjendet te populli (demos) dhe, si rrjedhojë, drejtimi i qyteteve, territoreve dhe kombeve duhet të jetë në duart e personave të zgjedhur dhe përgjegjës ndaj popullsisë. Gjithsesi, në e dimë se për rreth dy mijë vjet kjo recetë – *demokratia* ose demokracia – ka gjetur shumë pak përkrahës në botë. “*Qeveria e popullit, nga populli, për popullin*” – në formulimin lakonik amerikan të fund shekullit XVIII – është predikuar më shumë sesa është zbatuar.

Sigurisht që nuk është predikuar aq shumë, sepse të bëjë fushatë për *demokraci* do të ishte njësoj si të bëje tradhti ose herezi ose të dyja bashkë. Dhe kjo, sepse format mbizotëruese të qeverisjes – shembuj të të cilave gjenden edhe sot - ishin *autokracitë* dhe *teokracitë*. E para qëndron mbi kuptimin se pushteti absolut i jepet një individ të vetëm (perandorit, mbretit, carit, sheikut, sulltanit etj.) dhe monarku qeverisë drejtpërdrejt (me ose pa këshillat e të tjerëve). E dyta bazohet në besimin se pushteti suprem qëndron mbi unitetin. Kështu që qeverisja bëhet me anë të komandimeve hyjnore, sepse nga ato njerëzore, komunikimi i dëshirave të së shenjtës i besohet udhëheqësve shpirtërorë (papës, arqipeshkvit, ajatollahut/hoxhës etj.)

Shembujt e këtyre formave në ditët e sotme janë të mirënjohura dhe disa prej tyre nuk janë shumë larg nesh. Në Arabinë Saudite, Mbreti dhe familja mbretërore qeverisin në mënyrë autokratike. Fqinjët e tyre, shtetet Gulf, shehikët, sulltanët dhe emirët veprojnë po njësoj. Ndërkohë, në Iran ajatollahët qeverisin me të drejtën islamike, duke u kufizuar dhe duke arritur

nganjëherë te fanatizmi, megjithëse është rritur kohët e fundit kundërshtimi, duke u shoqëruar nga një kor protestash. Gjithashtu, edhe në shumë vende të tjera është ligji fetar ai që ushtrohet.

Këtu kam parashtruar një sërë vëzhgimesh. Së pari, si forma qeverisëse autokratike, edhe ajo teokratike, nënkuptojnë një autoritet më të lartë – një mundësi trashëgimie ose autorizim hyjnor. Në këtë mënyrë ata venë në jetë politikën “ç’thotë pushteti bën populli” dhe prodhojnë kështu regjimin autoritar (ndoshta edhe totalitarist). Dhe kjo nuk është e thënë të jetë e pasuportueshme: disa historianë e kanë përshkruar shekullin XVIII si shekulli i “despotizmit fisnik” në Europë. Gjithsesi, askush nuk ka deklaruar ndonjëherë se nën këto rregullime “njerëzit” ishin (ose janë) asgjë tjetër veçse objekte pasive të qeverisë, me shumë pak liri, duke gëzuar shumë pak të drejtat e kufizuara dhe privilegjet dhe duke ushtruar pak ose aspak ndikim mbi udhëheqësit e tyre.

Së dyti, është tepër e dukshme, se sa shpesh monarkët i vinin rëndësi të dyjave në të shkuarën: autoritetit jofetar dhe fetar, bazuar ose mbi paraardhënesit e tyre të shenjtë të dinastisë, ose mbi deklarinim e të drejtave hyjnore të mbretërve – të stilit europian – dhe ekuivalentët e tyre gjatë. Është shumë e qartë se ata kanë menduar se besnikëria e subjekteve do të ishte më e fuqishme, nëse respekti për sovranin do të përforcohej nga adhurimi për të hyjnishmen.

Së treti, është po njësoj e dukshme se sa shpesh, kur shoqëritë kanë zgjedhur “modelin” demokratik të qeverisjes, ata kanë zgjedhur të mbajnë institucionin e monarkisë së trashëgueshme, – pavarësisht se me një titullar sovran – për të dhënë midis gjërash të tjera një fokus të një besnikërie më të lartë sesa ajo e shoqëruar me bindjen ndaj ligjeve në vend, të vendosura nga qeveria në pushtet.

Për më tepër, siç mund ta dini, formula e të ashtuquajturës “monarki kushtetuese” mbetet ende popullore – në sensin e ngushtë të gëzimit e të miratimit të “popullit” - dhe kjo ndodh më shumë në kontinentin europian.

Kohët e fundit unë punoj dhe jetoj në dy shtete: në Mbretërinë e Bashkuar dhe Hollandë. Në secilin prej tyre *sundon* një mbretëreshë, por ato nuk *qeverisin*. Në asnjërën prej këtyre vendeve, njerëzit – mbi të cilët fuqia sunduese ekziston efektivisht – nuk duan ta shpërndajnë shprehjen simbolike të asaj fuqie të pasqyruar në trashëgimtarin e kreut të shtetit. Përkundrazi, ndodh krej e kundërta: ata e vlerësojnë këtë lloj rregullimi dhe madje e respektojnë “sovrantin” i cili fisnikëron emanipimin e tyre.

Për të kuptuar plotësisht mbajtjen (si në Britani dhe në Hollandë) – dhe madje restaurimin së fundmi (si në Spanjë) – të një dinastie monarkike brenda strukturave të një politike demokratike, duhen vlerësuar dilemat e “modelit” demokratik kudo që adoptohet.

E para nga këto është: si ta përshtasin konceptin e filosofëve grekë se fuqi i përket “popullit” së bashku me realitetin që është jopraktik për të gjithë “njerëzit” që të përfshihen në menaxhimin e përditshëm të çështjeve të tyre kolektive (përveç, ndoshta bashkësive shumë të vogla). Është e qartë se ka vetëm një zgjidhje. Popullsia duhet të zgjedhë përfaqësues që t’u shërbejnë atyre në këtë rol. Në ditët e sotme ne do të shtonim se kjo zgjedhje duhet bërë për zgjedhje të lira dhe të ndershme, duke u bazuar mbi të drejtat universale, të zbatuara brenda një sistemi gjeografik ose ndonjë sistemi tjetër ndarës – në mënyrë që të sigurohet një përfaqësim i vërtetë, i kuptueshëm dhe i baraspeshuar.

Kjo është dhe arsyeja themelore pse kemi Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bundestagun në Gjermani dhe të gjitha variantet e asambleve kombëtare, dhomat e deputetëve dhe kështu me rradhë. Përfaqësimi është qëllimi i ekzistencës së tyre. Është normale t’i konsiderosh organe të tilla si *legjislatura* – domethënë forume ligjberëse të territorit, dhe unë do të përdor këtë terminologji. Gjithsesi, për mendimin tim, një institucion përkufizohet nga ajo çfarë *është*, se sa nga ajo (ose ato) çfarë *bën*. Kështu që ne duhet që gjithmonë të mendojmë për karakterin përfaqësues të forumeve të zgjedhura. Ne duhet, gjithashtu, të vëmë re një

rrjedhojë të mprehtë, të cilës unë do t'i referohem më vonë. Anëtarësia në këto organe përfshin një detyrim për t'i shërbyer elektoratit (në shumë nga shoqëritë tona përfaqësuesit të zgjedhur i akordohet një status i caktuar, ai fiton një lloj prestigji, fiton një sërë avantazhesh). Dhe madje mund t'i jepet mundësia për përfitime vetjake. Si rrjedhojë, ne rastësisht gjendemi përballë një parlamentarit që është bërë shumë i/e rëndësishëm/e dhe që interesohet veçanërisht ta kthejë pozicionin e tij/saj në një avantazh *privat*. Dhe kuptohet, shumë individë në këtë mënyrë humbasin tërësisht “zotimin për t'i shërbyer demokracisë”.

Dilema e dytë e demokracisë është: si ta kuptojmë nocionin e qeverisjes “popull – pushtet” si të menaxhueshëm në një asamble përfaqësuese, me nevojën për (a) një qeveri eficiente (dhe për arsye praktike një individ – kryetar qeverie) dhe (b) një personifikim i pranueshëm i asaj fuqie, kryesisht për qëllime ceremoniale (që do të thotë një kryetar shteti, një qeverisës provincial, kryetar bashkie etj.). Në nivelin kombëtar kjo sfidë është ndeshur shpesh në dy rrugë, ose nga pikëpamja presidenciale, ose nga ajo kryeministore.

Nga pikëpamja *presidencial* “populli” zgjedh në mënyrë periodike një kryetar ekzekutiv – një politikan me përvojë, i zgjedhur drejtpërdrejt – i cili zgjedh pastaj me radhë një kabinet ministror dhe, së bashku me ta, merr përsipër drejtimin e burokracisë së përhershme shtetërore. Kryetari dhe skuadra e tij “zyrtarizohen” dhe vijnë në fuqi në kuptimin që në mënyrë kolektive, ata marrin funksione ekzekutive në qeveri, me udhëheqësin si kryetar qeverie. Nën disa rregullime kushtetuese kryetari ekzekutiv, gjithashtu, vepron edhe si kryetar shteti. Dhe me disa rregullime të tjera, një personalitet i respektuar kombëtar mund ta kryejë këtë rol.

Sipas pikëpamjes *kryeministore* “populli” zgjedh në mënyrë periodike asamblenë përfaqësuese (legjvënësin). Partia politike ose kualicioni politik, që ka përfaqësimin më të gjerë, formon një kabinet ministror – një “qeveri” ose administratë ose ekzekutiv – nën udhëheqjen e kryeministrit (që

zakonisht është kryetari i maxhorancës ose partisë zotëruese në parlament).

Kështu ky individ bëhet kryetar i qeverisë. Për sa i përket rolit të kryetarit të shtetit, kjo mund t'i besohet një personazhi të shquar ose i zgjedhur, ose i emëruar. Ka edhe një alternativë si në Mbretërinë e Bashkuar dhe Hollandë, që ai pozicion mund të plotësohet nga një monark kushtetues i cili “sundon por nuk qeverisë”.

Ka një sërë variantesh për pikëpamjet presidenciale ose kryeministore, për të kuptuar nevojat “popull – pushtet” në teorinë demokratike dhe detyrimet “shtet – popull” të administrimit efektiv. Secila nga të dyja format (dhe variantet) ka meritat dhe defektet e veta. Për shembull, ka disa avantazhe praktike të dukshme në të pasurit e vetëm të një kryetari shteti dhe qeverie – si në sistemin presidencial në SHBA. Njëkohësisht ka dhe probleme, sidomos kur përparësitë politike të kryetarit ekzekutiv dhe ato të maxhorancës në asamblenë përfaqësuese ndryshojnë nga njëra – tjetra. Kjo kërkon një “bashkëjetesë”, e cila mund të mos jetë e përshtatshme, madje mund të jetë dhe paralizuese. Por edhe në këtë rregullim të tillë dalin probleme: si për shembull, nëse punonjësit publikë (përfshi këtu edhe forcat e armatosura) duhet t'i qëndrojnë besnikë Kurorës ose administratës zyrtare. Për më tepër, kur kryetari i shtetit zgjidhet drejtpërdrejt dhe ka axhendën e tij/saj politike, shtrohet çështja e “bashkëjetesës” – siç është rasti së fundmi në Francë dhe për disa çështje edhe në Bullgari, Republikën Çeke, Poloni, Sllovaki dhe Rusi (dhe këto janë vetëm një pjesë e rasteve). Megjithatë, këto vështirësi zbehen në krahasim me problemet kryesore të demokracisë, e cila shoqërohet me nevojën për të imponuar respekt për pushtetin drejtues të “popullit” nga njëra anë dhe nevojën praktike për një qeverisje të fortë nga ana tjetër. I referohem, sigurisht, mundësisë që administrata mund të zotërohet tërësisht nga një individ i vetëm, nga një ideologji e vetme – ose një kombinim dhunshëm i të dyjave – ndërsa paraqitjet demokratike ruhen dhe legjitimiteti demokratik kërkohet.

Ky është një rrezik real, sidomos në shoqëritë e kushtëzuara prej

shekujsh nga regjimi autoritar me bindjen e heshtur ose të shtyrë nga një krizë politike, ose ekonomike, për të ekspozuar “një lidership të fuqishëm” si një preferencë e shprehur hapur. Kështu, në Beogradin e 1990-ës, Slobodan Milosheviçi drejtonte me kredenciale demokratike formalisht të shkëlqyera. Kështu që, për pjesën më të madhe të këtij shekulli, shumica e vendeve të të përfaqësuara këtu përjetuan një rrymë të socializmit dogmatik, i cili u prezantua me një retorikë bindëse demokratike të “fuqisë së popullit” dhe mbështetej nga doktrina e “centralizmit demokratik”, megjithëse në deklaratimet e mëvonshme ajo ishte thjesht një eufemizëm i mençur për pikëpamjen e thellë antidemokratike se “partia vendos” për çdo gjë. Kështu, që të citosh “kombinimin shkatëruës” që reflektoi hijen e vet mbi gjithë Europën për gati gjithë çerekun e dytë të shekullit XX, do të thotë të kujtosh Adolf Hitlerin dhe socializmin nacional që tronditi një Gjermani në krizë, të mbuluar nga varfëria dhe turpi mbi një mbështetje popullore.

Ka vetëm një mbrojtje kundër shpërfytyrimit të idealeve demokratike, që çdo ekzekutiv tepër zotërues mund të prodhojë dhe ruajtja e atyre idealeve, të cilat vijnë pandryshshëmrisht si pasojë e mbizotërimit të karizmës individuale ose monopolizimit të një ideologjie dogmatike.

Kjo është një asamble e fortë përfaqësuese ndaj së cilës kryetari i qeverisë dhe ministrat duhet të përgjigjen për gjithçka bëjnë. Gjithashtu, administrata duhet të jetë e disponueshme jo vetëm formalisht ose institucionalisht (domethënë se fuqia e legjislaturës duhet të jetë e qartë sipas kushtetutës), por edhe praktikisht (domethënë se përfaqësuesit e zgjedhur duhet ta ushtrojnë atë pushtet me vendosmëri).

Për më tepër, ka rëndësi edhe si ushtrohen këto pushtete. Këtu qëndron edhe rëndësia e “përgjegjësisë për të shërbyer”. Është përgjegjësia e parlamentarëve të sigurojnë që ekzekutivi vepron “për popullin” (siç e kanë vendosur themeluesit amerikanë). Kjo nënkupton shqyrtimin e propozimeve politike dhe mbështetjen e atyre, të cilat u përshtaten më mirë interesave kombëtarë, sesa interesave të ndonjë elite ose fraksioni. Kjo do

të thotë të shqyrtosh planet dhe programet për arritjen e qëllimeve politike dhe ligjërimitin e vetëm atyre, të cilat pritet të mbështeten gjerësisht nga popullsia. Do të thotë shqyrtim i buxheteve për realizimin e planeve dhe programeve dhe miratimin vetëm për ato fonde të cilat mund të përmbushin përparësitë shtetërore. Gjithashtu, do të thotë shqyrtim i politikave zbatuese, planeve, programeve e buxheteve dhe ekspozimi i rrethanave ku, për shembull, veprimi ekzekutiv bie në kundërshtim me politikën e deklaruar ose menaxhimi i burimeve ka qenë inefficent, joefektiv dhe joekonomik (raste të paligjshmërisë aktuale në përdorimin e burimeve – aty ku fondet nuk janë shpenzuar siç duhet – janë, sigurisht, çështje për të cilat duhet të ketë një gjykim të pavarur dhe të besueshëm. Megjithatë, përfaqësuesit e zgjedhur mund të jenë mekanizmat që i nxjerrin në dritë abuzime të tilla dhe kërkojnë riparimin e tyre).

Tashmë kemi arritur te konkluzioni i premtuar për rolin e rëndësishëm të legjislaturës (dhe ligjvënësve) në shoqëritë demokratike. Ashtu siç e pata shprehur dhe më lart, është një rol i dyfishtë.

Së pari, detyra themelore e parlamentarit është të përfaqësojë “popullin” në përgjithësi. Interesat e veçantë mund të kërkojnë një vëmendje të veçantë, por sistemi zgjedhor është në rradhë të parë një mjet për të siguruar që një dhomë e zgjedhur ofron “përfaqësim të vërtetë, të baraspeshuar dhe të kuptueshëm të zgjedhësve” dhe ata që janë zgjedhur t’i shërbejnë asaj, janë përfaqësuesit, jo delegatët.

Së dyti, përgjegjësia kryesore e përfaqësuesve të zgjedhur është të kontrollojnë pushtetin ekzekutiv në çdo kontekst që ky pushtet zbatohet: hartimi i politikave, planifikimi, programimi, hartimi i buxhetit. Përveç zgjedhjes më të përshtatshme të një asambleje të zgjedhur si legjislaturë, hartimi aktual i ligjeve është një funksion i rëndësishëm, por jo më i rëndësishmi (për mendimin tim).

Gjithashtu, ajo do të vazhdojë të përsërisë se teoria demokratike presupozon “një përgjegjësi për t’i shërbyer” shoqërisë së gjerë. Nëse një



ambicie e mirë të çon në preokupimin me vazhdimin e interesave vetjake (dhe të pasurisë) midis parlamentarëve, atëherë demokracia është në rrezik.

## II. DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË

Duke vendosur natyrën e rolit të legjislaturës në shoqëritë demokratike, unë duhet të merrem tani – disi më shkurtimisht – me disa çështje lidhur me detyrimet e ekzekutivit dhe përgjegjësitë e përfaqësueve (kjo do të jetë një parapërgatitje për vërejtjet e fundit mbi kushtet e nevojshme për një performancë efektive të rolit të tyre).

Duke filluar me “detyrimet e ekzekutivit”, është e dukshme se në një demokraci duhet të ketë një qeveri “të hapur”. Kjo do të thotë se administrimi i çështjeve kombëtare duhet të zbatohet pa shumë sekrete: parlamentarët dhe publiku duhet të jenë të mirinformuar për punët e qeverisë, duke përfshirë të paktën direktivat e përgjithshme, sipas të menduarit të autoriteteve para se të zbatohet politika e marrjes së vendimeve. Premisa filozofike që rrjedh nën këtë formë qeverisjeje – që pushteti absolut gjendet tek populli – kërkon zemërgjerësi. Gjykimi praktik – kontrolli parlamentar i asaj çfarë bëjnë ministrat dhe kryetari i qeverisë – e kërkon këtë gjë.

Prandaj ekzekutivi duhet të jetë i gatshëm për *transparancë* – nëse do të përdorja termin që është në modë kohët e fundit – si në çështjet e sigurimit të brendshëm, ashtu edhe në fusha të tjera. Ky nuk është një detyrim dhe aq i lehtë për t’u pranuar nga qeveritë. Në demokracitë “foshnja” të qenurit i hapur është zakonisht një nocion komplet i huaj. Në ato që më pëlqen t’i quaj demokraci “adoleshente” – shtetet, të cilat janë ende duke zbuluar se me çfarë ka të bëjë ajo – të shtyjnë kufijtë e sekretit shtetëror dhe në këtë mënyrë kufizimi i mundësisë, që autoritetet të manipulojnë informacionin publik, ka qenë rrallë reforma përparësore që duhet të ishte. Sigurisht që kemi parë dukurinë interesante të qeverive që dëshirojnë të përcjellin detaje për mjetet e tyre mbrojtëse ndaj qeverive të tjera – si në të ashtuquajturat Dokumentet e Vjenës, të hartuara nga besimi – dhe procesi

i ndërtimit të sigurimit të Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunim European (OSBE) – por të cilat nuk kanë pasur dëshirë që të njëjtin material t’ua jepnin edhe parlamentit ose publikut të tyre. Jo se kjo është e tëra e çuditshme, sepse edhe demokracitë e pjekura e shohin konceptin “transparencë” si diçka ngatërrestare. Sigurisht që ministrat e mbrojtjes dhe shefat e ushtrisë janë shpesh herë ambivalentë në lidhje me këtë gjë, pjesërisht sepse ata i referohen slloganit të vjetër se “informacioni është fuqi (kudo), pjesërisht sepse ata i shohin përgjegjësitë e tyre si veçanërisht sensitive (dhe se më pak të njohin karakterin e tyre dhe sa më pak ata të dinë, aq më mirë është).

Asnjë nga të mëparshmit, gjithsesi, nuk shqetësohet nga fakti se një ekzekutiv që nuk “ka detyrimin për transparencë” është një dështak në përmbushjen e detyrimit thelbësor demokratik; dhe një qeveri që iu jep të huajve një informacion që nuk është përgatitur për t’u shpërndarë edhe te legjislatura e vet, është një qeveri që i duhet ende kohë të kuptojë se çfarë është demokracia.

Kjo sjell edhe argumentin, të cilin unë e konsideroj si detyrimin thelbësor të një kryetari qeverie dhe të ministrave, që është të pranuarit se parlamentarët *kanë të drejtën të dinë* çdo gjë që duhet ditur për çështjet e administrimit.

Në praktikë, komunikimi i informacionit ose dhënia e tij mbi baza kufizimi, normalisht rregullohet mbi bazat e nevojës *për të ditur*. Kjo ndoshta mohohet vazhdimisht në shumë fusha: për shembull, për sa i përket informacionit mbi ndryshimet më të fundit të taksave ose blerjeve të synuara të pronave të patundshme; ose edhe në çështje që janë ende në negociim e sipër me qeveri të tjera ose institute ndërkombëtare; ose në sferën e mbrojtjes, në lidhje me të dhëna mbi mundësinë e saktë të armëve specifike ose gjendjes stok të këtyre armëve, duhet të ketë në fakt disa “sekrete shtetërore”. Jashtë këtyre fushave, liria e shtypit duhet të zbatohet. Për më tepër, këto kufizime praktike, pa të cilat do të ishte e pamundur të drejtohej vendi, nuk e prakin parimin se “e drejta për të ditur/njohur” është thelbësore.

Në fakt, mundësia që u jepet parlamentarëve për informacion është sigurisht një mundësi që rrjedh nga e drejta e popullit për të njohur/ditur se çfarë bëhet në emrin e tij (kujtoni këtu *demokratia*). Çështja e informacionit publik, si një detyrim ekzekutiv dhe legjislativ, nuk është një nga ato gjëra me të cilat do të merrem. Ajo çfarë dua të theksoj këtu është lidhja që ekziston midis tyre. Duke argumentuar nëse një ekzekutiv duhet t'i transmetojë fakte dhe shifra përfaqësuesve të popullit, është në fakt duke ushtruar të drejtën e publikut për të njohur/ditur. Implikimi logjik i kësaj çështjeje është se informacioni që i jepet legjislaturës duhet që, sa të jetë e mundur, të bëhet publik (në të njëjtën kohë ose ndërkohë).

Zotimi për transparencë dhe njohja e së drejtës të përfaqësuesve të zgjedhur për të njohur/ditur për çfarë ndodh janë detyrimet themelore të një forme qeverisjeje demokratike. Megjithatë, ato janë detyrime të përgjithshme. Po ç'bëhet me detajet e çështjeve të përditshme në bërjen e politikës dhe të administratës publike? Cilat janë detyrimet specifike për to? Përgjigjja e shkurtër do të ishte se ka vetëm një kërkesë të vetme gjithëpërfshirëse, e përmbledhur në përkufizimin se kryetari i qeverisë dhe ministrat (si dhe burokracia e përhershme) janë përgjegjës para legjislaturrës – dhe nëpërmjet dhomës së zgjedhur, edhe para shoqërisë së gjerë – për gjithçka ata bëjnë. Me fjalë të tjera përgjegjësia e ekzekutivit është thelbi i politikave praktike demokratike. Është e qartë se ky konceptim kërkon edhe sqarime.

Me raportim nënkuptojmë dy gjëra, që reflektojnë të dyja kuptimet ku mund të gjejmë rrënjën e fjalës “llogari – si emër dhe si folje – që përdoret në anglisht. Mua më duhet që ta sqaroj këtë dualitet (dykuptimësi) para se të vazhdoj (më duhet edhe t'ju kërkoj ndjesë për këtë shpjegim të vogël gjuhësor):

1. Unë mund të them “Jep llogari/raporto për çfarë ke bërë dje” dhe unë pres si përgjigje që ju do të më bëni të ditur dhe do të më shpjegoni një sërë veprimesh dhe vendimesh.

2. Unë mund të them “Më trego llogaritë për këtë ose atë veprimtari”; dhe unë pres që ju të më deklaroni dhe, nëse kërkohet, edhe të justifikoni shpenzimet tuaja për qëllimin e caktuar.

Dykuptimësia vjen sepse në anglisht ne përdorim fjalën “llogari” (account) për të dyja idetë. Në disa gjuhë të tjera ka fjalë të ndryshme për të dyja rastet e ndryshme, por të lidhura me njëra – tjetrën në kuptimin e përgjegjësive – çka është shumë e kuptueshme dhe e përshtatshme.

Në frëngjisht, për shembull, do të përdornim raconter (tregoj) për të parën, dhe bëj të qartë/raportoju ose rendre des compte për të dytën. Unë shpresoj që në shumë nga gjuhët tuaja të ekzistojë i njëjti ndryshim.

Duke vazhduar drejtpërdrejt nga ky sqarim – pra shpjegimi gjuhësor mbaroi – ne mund të përcaktojmë tani raportimin ekzekutiv, që përfshin në vetvete:

- një detyrim për të nxjerrë dhe shpjeguar veprime dhe vendime në të gjitha fushat e marrëdhënieve publike (përfshirë këtu edhe fushën e sigurimit kombëtar); dhe

- një detyrim për të deklaruar dhe justifikuar shpenzimet për qëllime publike (duke përfshirë mbrojtjen dhe sigurimin).

Mund ta quajmë të parën *përgjegjësi politike*. Dhe të dytën mund ta quajmë *raportim financiar*. Të dyja mund të pranohen nga administrata nëse legjislatura e një vendi duhet të luajë funksionin e saj qendror mbikëqyrës në mënyrë efektive.

Duke iu kthyer tani “përgjegjësive të përfaqësuesve” – tema e dytë e kësaj pjese të prezantimit tim – do të ishte më e përshtatshme të rimerrnim argumentin e mëparshëm. Dhe kjo sepse, të flasim hapur, detyrat e kërkura janë imazhe të reflektuara të detyrimeve të ekzekutivit që sapo përshkruam.

Kështu që thelbi i politikave praktike demokratike, të para nga pikëpamja e dhomës së zgjedhur, është ushtrimi i kontrollit legjislativ nga pushtetarët; dhe kjo arrihet duke krijuar një administratë që jep llogari/raporton për politikën; ajo përgjigjet dhe për paratë e taksapaguesve që

harxhohen. Në praktikë është disi më e komplikuar se kaq. Ashtu siç e përmenda më sipër, mbikëqyrja kërkon (a) shqyrtimin e formulimit të politikave nga eksplorimi i aspiratave deri në hartimin e objektivave konkrete; dhe (b) zbatimin e politikës nga hartimi i planeve dhe programeve për përmbushjen e objektivave deri tek ndërtimi i një buxheti që i lehtëson ato. Duhet të ketë, gjithashtu, vlerësime periodike të politikave të mëparshme. Edhe kjo kërkon shqyrtimin e (i) alokimit të burimeve, si dhe për çfarë arsye fondet alokohen pavarësisht nga përparësitë kombëtare dhe përparësitë sektoriale (për shembull në mbrojtje); dhe (ii) menaxhimit të burimeve – duke u fokusuar në përdorimin e fondeve jo vetëm nga ana ligjore dhe efektiviteti (funksioni i revizionimit të vlerës së lekut). Këto janë imazhet reflektive të një përgjegjësie politike dhe të një raportimi financiar.

Është e pamundur të imagjinosh një asamble të zgjedhur “që i kërkon administratës të raportoje” në mënyrë serioze, kur ajo është e pafuqishme të kërkojë njerëzit dhe dokumentet që do të merren në pyetje dhe do të inspektohen në mënyrë që të japin një ekzaminim të thellë e të detajuar. Le ta shohim nga ana tjetër; është e pamundur të ketë mbikëqyrje të kuptimshme, nëse legjislaturës i mohohet e drejta për t’u informuar, të paktën direktivat e përgjithshme të të menduarit të administratës para se të merren vendime politike dhe për objektivat kur vendimet janë marrë (kështu që mund të funksionojë si ndërmjetës në formulimin e politikës); dhe për përmbajtjen e planeve rezultative qeveritare, të programeve dhe buxheteve (kështu që mund të kenë akses për materialet e detajuara për shpenzimet e paramenduara, mundësisht edhe të dhëna në lidhje me financimin e programeve – dhe si të tilla objektivat – dhe idealisht projektimet shumëvjeçare dhe jo thjesht shifra të fundit ose të fillimit të vitit pasardhës (nëse duhet të miratojnë alokimin e burimeve); dhe ata duhet të marrin një tabelë të detajuar të shpenzimeve mbi personelin, pajisjet dhe projektet kapitale në çdo fushë të biznesit qeveritar (nëse duan të përmbushin përgjegjësitë e tyre klasike dhe monetare të revizionimit). Asnjë nga këto

fakte dhe shifra nuk do të jenë pasuese derisa përfaqësuesit e zgjedhur të kenë vendosur “të drejtën e tyre për të ditur/njohur” për çështjet ekzistuese.

Për mendimin tim, kjo është pika që demokracitë adoleshente shpesh e kanë të pamundur të bëjnë përparime vendimtare në transformimin e tyre nga qeverisje njëpartiake shumë sekretive në një politikë pluraliste. Sigurisht, unë do të shkoja aq larg sa të thosha se vendosja e të drejtës për të njohur – përfshi këtu presidentët dhe politikanët drejtues, burokratët dhe gjeneralët – mund të jetë sfida e vetme më e madhe që ndeshin përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike në shtete të tilla. Zakonet e qeverisjes autoritare mbizotërojnë. “E drejta” nuk vendoset lehtë. As nuk është njohur – ose pranuar – në shumë, në mos në të gjitha vendet. Megjithatë, me kurajo duhet të deklarohet, të fitohet dhe më pas të konsolidohet. Derisa të ndodhë kjo, risitë formale kushtetuese në lidhje me raportimin e ekzekutivit, në lidhje me çështjet e sigurimit kombëtar ose ndonjë fushe tjetër e veprimtarisë shtetërore, nuk mund të jenë shumë të besueshme.

Demokracia do të mbetet anemike, kudo që qeveritarët ose nëpunësit nuk janë plotësisht të gatshëm për detyrimin e tyre për transparencë, aty ku nuk ka një dedikim real për një qeverisje “të hapur”. Një nga arsytet për këtë gjë është se të qenurit të hapur është një parakusht për një emergjencë – në fushën tonë specifike të interesit – për një “bashkësi sigurimi” të organizatave joqeveritare (OJQ), të akademikëve, të njerëzve të ditur, të cilët u kushtojnë vëmendje këtyre problemeve dhe informacionit për çështjet e sigurimit, të trajtuara në shtypin e shkruar dhe median elektronike. Ky kombinim është i vlefshëm sepse jo vetëm që e ushqen legjislaturën dhe përmirëson aftësinë e përfaqësuesve të zgjedhur, për të ushtruar mbikëqyrje, por edhe mund të sjellë informacion dhe të nxisë debate, duke lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërisë së gjerë në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen. Kjo bën që ky argument i veçantë të mbyllë rrethin – “nga populli te populli”.

### III. INSTITUCIONET DHE PROCEDURAT

Emergenca për një “bashkësi sigurimi” dhe një trajtim informativ i çështjeve të sigurimit në media mund të ndihmojë parlamentarët të luajnë më mirë rolin e tyre mbikëqyrës; dhe përfshirja e interesit “të popullit” në çështjet e sigurimit mund të jetë një motivim i mirë për ta bërë atë. Megjithatë, institucionet dhe procedurat nëpërmjet të cilave ushtrohet formalisht ky rol – një sërë setesh në të cilat përfaqësuesit e zgjedhur mund të veprojnë në skenën politike - janë në këtë rast një kusht i nevojshëm për efektivitet. Unë ju premtova se do t’ju numëroja disa të tilla, gjë që do të jetë elementi i fundit në ndihmesën time në këtë takim.

Unë jo më kot përdor fjalën “numërim”. Unë do t’ju ofroj – me pak komente – një listë të atyre, që sipas mendimit tim janë masat “ideale” që mund të merren.

Ashtu siç e përmenda dhe më lart, ka shumë demokraci të pjekura ku strukturat dhe proceset janë shumë larg ideale. Arsyeja për mungesën e komentit të detajuar është se ajo çfarë institucionet dhe procedura të veçanta mund dhe nuk mund të kryejnë është subjekti i një sërë prezantimesh dhe diskutimesh të mëvonshme. Arsyeja për të përmendur një listë mjetesh është që t’ju aftësoja ju, nëse e dëshironi, të përdorni numërimin tim për të kontrolluar situatën e vendit tuaj (dhe sigurisht atë të demokracive të tjera foshnja, adoleshente ose edhe të pjekura sipas zgjedhjes suaj). Unë, së pari, do të trajtoj institucionet, më pas procedurat dhe kjo për ta bërë më praktike.

#### 1. Institucionet

1.1 Komisionet me specialistë janë një komponent kyç për një kornizë institucionale të mirë, në mënyrë që të ushtrohet një mbikëqyrje efektive. Janë shumë të rëndësishme sidomos në arenën e sigurimit kombëtar. E tillë është shumëllojshmëria e punëve të qeverisë mbi të cilat ekzekutivi duhet të japë llogari/raportojë, sepse ndarja e punës është e nevojshme nëse shqyrtimi duhet të bëhet i saktë dhe jospërfaqësor. Këtu mund të futet edhe

ekspertiza dhe të përdoret me efekt të mirë në pyetjen e individëve në seancat formale “dëgjuese” dhe në inspektimin e dokumenteve në mënyrë të vazhdueshme (me ose pa ndihmë nga “bashkësia e sigurimit kombëtar). Tekstet e “seancave dëgjuese” dhe raportet e komiteteve të strukturuar mund të jenë të rëndësishme në debatin politik dhe në ngritjen e alokimeve të burimeve dhe menaxhimit të burimeve (si nga aspekti qeveritar dhe nga fusha të veçana si mbrojtja).

1.2 Stafit i përhershëm parlamentar janë ata që ushtria do t’i quante “forca rezerviste” përse i përket efektivitetit të komisioneve me specialistë (dhe sigurisht në shërbimin e dhomës së zgjedhur si një të tërë dhe natyrisht si individë). Për vetë shkallën e saj absolute, intensiteti i mbikëqyrjes dhe fuqive kushtetuese të Kongresit të SHBA-së për shembull – për të bërë ndryshime zërash në Buxhetin e Presidentit – grupimi në Capitol Hill nuk mund të imitohet diku tjetër, për mendimin tim, dhe askush nuk duhet të përpiqet ta bëjë këtë. Gjithsesi, unë nuk di të ketë ndonjë vend që nuk do të përfitonte shumë duke u përpjekur të rekrutojë persona cilësorë si anëtarë të (shumicës) komitetit, anëtarë të Shërbimeve Kërkimore të Kongresit dhe punonjës të Bibliotekës së Kongresit. Shumë legjislatura europiane janë rregulluar mirë në këtë drejtim, si dhe Sekretarriati i Asamblesë Parlamentare të NATO-s ofron trajnime të shkëlqyeshme për njerëzit që vijnë nga vendet partnere të NATO-s ose vende aspiruese për të hyrë në NATO.

1.3 Një zyrë revizionimi e respektuar dhe e mirorganizuar (dhomë ose gjykatë) është një armë e fuqishme dhe jetësore e legjislaturës, natyrisht me një domethënie të posaçme, kur është fjala për performancën e të dyja funksioneve të revizionimit, asaj klasike dhe asaj monetare. Një harmonizim i tillë i stafit profesional është trupi supervizues kryesor financiar i një parlamenti, gjithmonë në kërkim të mashtrimeve, humbjeve dhe menaxhimit të keq (plus raste më pak spektakulare të përdorimit të burimeve në mënyrë joekonomike, inefikase dhe inefektive). Përsëri, qëllimi dhe shkalla e punës të institucionit të SHBA-së – Zyra e Përgjithshme e Raportimit (GAO) – japin një model jopraktik për vendet e tjera. Gjithsesi, Zyra Kombëtare e



Revizionimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO) – për të cilën punoj nganjëherë – është një trup më modest, por jo më pak i mirorganizuar, që mund të mësojë shumë në lidhje me operacionet në fushën e revizionimit të mbrojtjes (ashtu siç janë edhe disa zyra të tjera europiane). Duhet thënë, kjo është bindja ime, se si rregull çdo vend duhet të shfaqë masat e saja në këtë fushë, nëse ka nevojë edhe të fillojë nga ca pika të vogla fillimi. Masat paraprake të marra mund të përfshijnë kushtet vendore, mundësisht të përfshijnë masa mbrojtëse kundër përjashtimeve ose disfatave të kërkimeve të zyrës – ose kërcënimit të personelit të saj – nëse ekziston ose mund të ekzistojë një ekzekutiv me tendenca autoritare (antidemokratike).

## 2. Procedurat

Unë përmenda “seancat” e komisioneve me specialistë dhe raportet plus investigimet e zyrave revizionuese, të cilat me argumente qëndrojnë nën titullin “procedurat”. Masa ime ideale për një performancë efektive të rolit të dyfishtë të legjislaturës (roli përfaqësues dhe mbikëqyrës) në çështjet e sigurimit kombëtar, gjithsesi do të përfshinte më shumë se kaq.

*2.1 Interpelanca* është një procedurë demokratike – ndoshta është edhe institucion – i cili edhe pse jo i praktikuar kudo, është shumë i çmuar aty ku ekziston. T’i kërkosh një kryeministri ose kryetari të ekzekutivit dhe kryetarëve të departamenteve si Ministrin të Mbrojtjes, që në mënyrë periodike të dalë para dhomës së Parlamentit dhe t’u përgjigjet pyetjeve të bëra më parë, si dhe mundësisht pyetjeve suplementare, është në radhë të parë një pjesë e mrekullueshme e simbolizmit politik. Ekzekutivi është kështu i pyetshëm nga “populli” (nëpërmjet përfaqësuesve të tij të zgjedhur). Kjo është përgjegjshmëri/raportim në formën më të pastër, e drejtprëdrejtë dhe vetjake. Në radhë të dytë, ky është dhe një rregullim funksional. Ajo lejon çështjet e përgjithshme të trajtohen. Ajo lejon çështje të veçanta të sqarohen qoftë për kuptimshmëri mbarëkombëtare ose për një interes të veçantë konstituor. Ajo mund të jetë një mjet për të nxjerrë informacion, të cilin ekzekutivi mund të mos ketë pasur dëshirë ta tregojë, ose për të kërkuar një

justifikim të saktë për një veprim të caktuar, për të cilin administrata ka preferuar të rezervohet. Këtu nënvizoj, gjithashtu, se ekzistenca e vet procedurës prodhon mjaft rezultate. Tregohet me shumë kujdes, në të gjitha aspektet e qeverisjes, kur njerëzit e dinë se për çfarë mund të thirret për të raportuar ministri; dhe vendimmarrja politike dhe administrative publike janë më të mira për të (e njëjta gjë qëndron sigurisht edhe për prospektin e një daljeje para një komisioni specialistësh që ka fituar një reputacion në pyetjet kërkuese ose një investigim nga një zyrë revizionimi, akuzat e të cilës mund të precipitojnë në dështimin e një politikani ose nëpunësi).

2.2 Nevoja për *debate specifike* në raste specifike është, gjithashtu, shumë e rëndësishme. Paraqitja e deklaramit të një politike të rëndësishme qeveritare (një doktrinë e re ose një koncept kombëtar sigurimi i ri, në gjuhën e bllokut lindor) ose të një raporti madhor parlamentar ose të të dhënave të një evidence (nga një komision specialistësh ose trupi revizionues), ngjarje të tilla, për mendimin tim duhet të shënohen si shkëmbime para gjithë dhomës së zgjedhur, edhe nëse rregullat kushtetuese nuk e kërkojnë këtë gjë. Praktika i jep thelbin raportimit. Orari i legjislaturës duhet të jetë mjaft fleksibël, që të rregullojë ushtrimin e lëvizjeve të tilla.

2.3 Axhenda duhet, gjithashtu, të përmbajë debate staturore ose rutine. Më e rëndësishmja nga këto është sigurisht shqyrtimi i buxhetit shtetëror, rasti kur përfaqësuesit e zgjedhur ushtrojnë “fuqinë e kuletës” (e cila duhet të jetojë gjithmonë me legjislaturën për të paktën dy arsye: respektimin e parimit “s’ka taksa pa përfaqësim” dhe për të drejtën për të qenë arbitri përfundimtar i përparësive të shpenzimeve kombëtare). Për më tepër, megjithëse ka një rast të mirë për rishqyrtime dhe rimiratime periodike – le të themi vjetore ose dyvjeçare – të statuteve të caktuara madhore, një kategori në të cilën mund të përfshihet legjislacioni në lidhje me ngritjen dhe mirëmbajtjen e ushtrisë dhe të strukturave të tjera të armatosura shtetërore. Midis të tjerash, kjo siguron raportimin zyrtar të rregullt në këtë fushë që i përshtatet ushtrimit vjetor të raportimit financiar, shqyrtimin e të cilit e përfaqëson buxheti.

2.4 Si publikimet e rregullta edhe ato të rastësishme – përfshi këtu edhe çështjet e sigurimit ndërkombëtar – janë në vetvete një nevojë për një mbikëqyrje efektive legjislative ndaj ekzekutivit, si dhe një njohje e saktë e “të drejtës thelbësore për të njohur” që ka parlamenti dhe publiku dhe shprehjes reale të një “zotimi për transparencë” dhe qeverisjeje “të hapur”.

Listëkontrolli im minimal për publikimet periodike të mbrojtjes do të përfshinte: një deklaram politikash madhore njëvjeçare ose dyvjeçare, së bashku me një raport mbi veprimtarinë diplomatike, në lidhje me sigurimin dhe operacionet ushtarake, plus edhe një buxhet përmbledhës; një buxhet i detajuar për vitin që pason, duke i bashkëngjitur edhe një program, nëse është e praktikueshme, plus dhe një pasqyrë parashikuese për shpenzimet deri në pesë vitet e ardhshme; dhe llogaritë vjetore të vërtetuara të dalin jo më vonë se dy vjet nga periudha të cilës i përkasin, që është intervali i nevojshëm që paraqet kërkesën praktike për të mbyllur llogaritë dhe për t’u siguruar se të dhënat financiare janë revizionuar dhe janë gjetur në rregull (ose në të kundërt, sipas rastit). Unë, gjithashtu, do të shpresoja se shumë asamble të zgjedhura në kohën e duhur do të nxisin (a) dhënien e raporteve në një stil modern menaxhimi, (b) deklaramin e projekteve të mëdha, dokumentacionin e programeve të blerjes së armëve me status dhe vlerë të lartë dhe ekspozimin e çdo lloji tejkalimi të koston ose vonesave që mund të ndeshen me to, dhe (c) një raport të fuqisë punëtore që dokumenton rekrutimet e bëra, pushimin nga puna ose daljen në pension dhe dhënien e paralajmërimeve për probleme të pritshme në fushën e personelit (nëse ka).

Si përfundim, unë nuk do të përpiqem për një përmbledhje të gjithë atyre që u thanë tashmë. Megjithatë, unë do të rishtroja edhe një herë ftesën, që ju të përdornit listëkontrollin tim me 7 pika, për të vlerësuar përgatitjen për një performancë efektive të rolit të legjislaturës suaj në një punë serioze në qeverisjen demokratike, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të sigurimit kombëtar.

# Komisionet parlamentare të hetimit: instrumente të rëndësishme kontrolli

*Vështrim krahasues*

*Nga Sokol Berberi*

## HYRJJE

Komisionet parlamentare të hetimit janë instrumente të rëndësishme të Parlamentit për kryerjen e kontrollit mbi ekzekutivin, si dhe për mbledhjen e informacionit për çështje të rëndësishme me interes publik, me qëllim arritjen në përfundime të caktuara politike.

Përdorimi sa më i drejtë dhe efektiv i këtij instrumenti kontrolli lidhet me traditën dhe kulturën parlamentare e demokratike të një vendi të caktuar, por në të njëjtën kohë dhe me bazën ligjore që rregullon organizimin dhe funksionimin e komisioneve të hetimit.

Në këtë shkrim do të paraqesim në fillim një vështrim të përgjithshëm se si janë të rregulluara çështjet kryesore, që lidhen me hetimet parlamentare në vendet e Bashkimit Europian dhe më pas përvojën shqiptare në këtë drejtim.

## HETIMET PARLAMENTARE NË VENDET E BASHKIMIT EUROPIAN<sup>1</sup>

Bazuar në analizën e të dhënave institucionale për shtetet objekt i studimit, vërehet se 11 prej tyre i kanë akorduar komisioneve hetimore

---

1. Vlerësimet e paraqitura referohen nga materiali “Les Commissions parlementaires d’enquete des Etats membres de la CE”, documentation et evaluation juridique compara-

parlamentare pushtet kontrolli ndaj pushtetit ekzekutiv. Vetëm Mbretëria e Bashkuar bën përjashtim. Që prej vitit 1921, veprimtaria informative për probleme shqetësuese në sektorin publik i është besuar institucioneve që janë të pavarura nga Parlamenti. Fakti që hetimi i shpëton ndikimit të rretheve politike merret si i mirëqenë për arsyen e sigurimit të paanësisë së tij. “Tribunals of Inquiry”, të cilat e gëzojnë këtë pushtet kontrolli, kanë në përbërjen e tyre gjyqtarë. Përkundrazi, shtetet e tjera anëtare përpiqen të garantojnë pavarësinë e komisioneve hetimore parlamentare nëpërmjet dispozitave rregulluese, të tilla si dhënia e të drejtave për minorancën dhe respekti i këtyre të fundit.

Çështjet kryesore që do të trajtohen në këtë vështrim krahasues janë: baza juridike; krijimi; kohëzgjatja e mandatit; përbërja; fusha e veprimtarisë dhe kufizimet; kompetencat; përfundimet.

#### a. Bazat juridike

Krahasimi i bazave juridike, lidhur me mandatet e komisioneve hetimore parlamentare, tregon që e drejta e hetimit është e pranishme në kushtetutat e nëntë prej dymbëdhjetë shteteve anëtare. Kjo gjë ilustron rëndësinë që i jepet këtij instrumenti të kontrollit parlamentar. Ndërkohë që kushtetutat e shumicës së shteteve anëtare kënaqen me dhënien e të drejtës hetimore, të tjera (p.sh. Itali, Spanjë, Gjermani) përmbajnë dispozita më të sakta lidhur me mënyrat e ushtrimit të së drejtës hetimore parlamentare. Megjithatë, rregullimi i detajuar i organizimit, funksionimit dhe i kompetencave bëhet në ligje të veçanta ose në rregulloret e brendshme të asambleve parlamentare.

---

tive; document de travail; Direction General des Etudes, Parlement Europeen, W-3, 1993. Në studim përfshihen shtetet: Gjermania, Belgjika, Luksemburgu, Franca, Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Italia, Spanja, Portugalia, Greqia, Danimarka.

Gjermania dallohet nga fakti se vetë Grundgesetz (Ligji themelor i shtetit), në nenin 44 të saj, parashtron orientimet e mëdha, por nuk parashikon, në një formë të detyrueshme, aktet që duhet të rregullojnë zbatimin.

Në Francë, e drejta e hetimit parlamentar është rregulluar me një urdhëresë. Zbatimi i saj rregullohet nëpërmjet ligjeve të veçanta dhe me disa dispozita të rregullores së brendshme të asambleve. Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda janë të vetmet shtete anëtare, ku rregullorja e brendshme e asambleve parlamentare përbën bazën e vetme juridike të hetimeve (parlamentare).

#### b. Krijimi

Në të gjitha shtetet anëtare, komisionet hetimore parlamentare krijohen nga një ose të dy dhomat, si rrjedhim i një vendimi të marrë nga votimi i mazhorancës. Bëhet fjalë, pra, për “hetime me votë mazhoritare”. Vendimi i parlamentit duhet të paraprihet nga një kërkesë për krijimin e komisionit, kërkesë, e cila duhet të motivohet siç duhet. Numri i personave të nevojshëm për ta bërë të vlefshme këtë kërkesë ndryshon sipas shteteve anëtare. Kështu, në disa prej shteteve anëtare, mjafton vetëm një deputet për të futur këtë kërkesë (Danimarka, Holanda), ndërsa shumica e tyre kanë caktuar një numër minimal të kërkuar. Përkundrazi, në Spanjë, e drejta për të depozituar një kërkesë të tillë i njihet qeverisë, një grupi parlamentar dhe presidiumit; në Portugali, kjo gjë i njihet qeverisë, grupit parlamentar dhe komisioneve parlamentare ekzistuese.

“Minderheitenenquete” (hetim me votë minoritare), parashikuar në rregulloren gjermane, përbën një përjashtim në nivelin e BE-së. Në fakt, ¼ e anëtarëve të Bundestagut mund të kërkojë krijimin e një komisioni hetimor, edhe në rastin e një votimi mazhoritar të kundërt. E drejta e hetimit parlamentar është zhvilluar në kuptimin e së drejtës reale të minoriteteve, me qëllim që t’i japë opozitës parlamentare një pozicion më të fortë. Ideja,

që lë të nënkuptohet ky parim, është se mazhoranca parlamentare dhe pra, ajo qeveritare nuk ka përgjithësisht asnjë dëshirë që të plogështojë qeverinë “e saj”, dhe ajo do të mbajë një qëndrim të heshtur, madje në të vërtetë të kundërt ndaj krijimit të komisioneve hetimore të destinuara që të kontrollojnë pushtetin ekzekutiv. Është interesante të theksohet se i njëjti argument është parashtruar nga shtete të tjera anëtare, për të shpjeguar numrin e kufizuar të komisioneve hetimore të krijuara deri më sot.

#### c. Kohëzgjatja e mandatit

Në të gjitha shtetet anëtare, funksionet e komisioneve hetimore mbarojnë në fund të veprimtarisë të tyre hetimor, me fjalë të tjera, kur depozitohet raporti përfundimtar për to. Në rast të kundërt, kohëzgjatja e mandatit të komisionit hetimor caktohet me vendim konstitutiv të asamblesë parlamentare përgjegjëse. Duke qenë se vjen nga parlamenti, komisioni hetimor preket nga detyrimet kohore të këtij të fundit (parlamentit). Në parim, zgjatja e mandatit të komisionit nga parlamenti është megjithatë i mundshëm. Për më tepër, asambleja ka të drejtë ta shpërndajë komisionin përpara mbarimit të mandatit të tij. Franca është i vetmi shtet që e detyron sistematikisht komisionin hetimor t’u japë fund punimeve të tij jo më vonë se gjashtë muaj pas krijimit të tij dhe sapo bëhet hapja e procedurës së hetimit gjyqësor. Gjithashtu, Franca ka veçorinë që ndalon krijimin e një komisioni të ri hetimor për një problem që është trajtuar gjatë 12 muajve që pasojnë fundin e punës së komisionit të ngarkuar me hetimin e mëparshëm. Kjo kërkesë mund të konsiderohet si një kufizim (kohor) që lidhet me punët e komisionit.

Fundi i legjislaturës përbën një formë tjetër të kufizimit kohor në punën hetimore të një komisioni, e cila zbatohet në gjashtë prej dymbëdhjetë shteteve anëtare (Gjermania, Belgjika, Luksemburgu, Spanja, Greqia dhe Danimarka). Fundi i legjislaturës shënon automatikisht fundin e funksioneve të komisioneve, në mënyrë të tillë që në fillim të legjislaturës së mëvonshme,

është i domosdoshëm një vendim i ri i parlamentit të sapo zgjedhur, për t'i lejuar komisionit të ndjekë hetimin e tij. Kjo situatë rezulton nga fakti që komisioni hetimor buron nga parlamenti dhe, prandaj, ai duhet të jetë i legjitimuar nga parlamenti (i ri) i zgjedhur.

#### ç. Përbërja

Përsa i takon përbërjes së komisioneve hetimore, duhet të vërejmë se, në shumicën e shteteve anëtare, nuk ekziston asnjë parashikim i caktuar lidhur me numrin e anëtarëve të tyre. Si rregull i përgjithshëm, vërehet vullneti për të respektuar raportin e forcave midis partive të ndryshme dhe/ose grupeve parlamentare, ku secili prej tyre duhet të jetë i përfaqësuar nga të paktën një anëtar. Kjo i garanton çdo grupi të drejtën për të ndërhyrë në hetimet që kryhen. Pra, komisionet reflektojnë, në një shkallë të vogël, parlamentet prej nga vijnë, të paktën ato reflektojnë përbërjet e tyre. Përfaqësimi proporcional i grupeve të ndryshëm parlamentare bën të detyrueshme, ipso facto<sup>2</sup>, një numër minimal të anëtarëve në komisionet hetimore.

Të gjitha shtetet njohin domosdoshmërinë e kufizimit në maksimum të numrit të anëtarëve të komisionit. Kjo është e vetmja mënyrë që i lejon komisionit të përfundojë si duhet një hetim kompleks dhe të shmangë rrezikun e zgjatjes së procesit të marrjes së vendimit ose të procedurave të brendshme. Dhe më tej, Irlanda dallohet për faktin se anëtarët e komisioneve caktohen në mënyrë nominale nga një komision i veçantë që kryen emërimet.

#### d. Fusha e veprimtarisë dhe kufizimet

Në të gjitha shtetet anëtare, fusha e veprimtarisë, që u njihet komisioneve hetimore, është shumë e gjerë. Kështu që pushteti i marrjes së informacionit

---

2. Ipso facto (latinisht) – që bëhet pa asnjë formalitet (kur është fjala për një ndryshim juridik)



të komisioneve shtrihet për “probleme ose çështje të interesit të përgjithshëm” ose për “çështje të rëndësisë së përgjithshme”. Nëse i qëndrojmë strikt këtij formulimi, komisionet hetimore gëzojnë të drejtën e hetimit praktikisht në të gjitha fushat. Është kjo arsyeja që disa shtete anëtare (Gjermania, Luksemburgu, Belgjika, Portugalia) vendosin një kufizim nëpërmjet respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve.

Si pasojë, problemet, që nuk i përkasin përgjegjësisë kushtetuese të parlamentit, nuk mund të jenë objekt i hetimit. Në këtë rast bëhet fjalë për të penguar që punimet e një komisioni hetimor të çojnë në një transferim kompetencash që nuk parashikohen në ligj dhe, kështu, në një përshtjellim pushtetesh. Në Gjermani, përveç kësaj, problemet korrente të trajtuara nga qeveria nuk mund të jenë objekt i hetimit. Në të gjitha shtetet anëtare, përmbajtja konkrete dhe gjerësia e objektit hetimor caktohen me vendim konstitutiv të parlamentit. Që prej këtij çasti, misioni i hetimit nuk mund të tejkalohet kufijtë e mandatit që është dhënë.

Në të kundërt, shtetet anëtare i japin përgjigje të ndryshme problemit nëse një procedurë gjyqësore, ende e pazgjidhur ose që do të kryhet shumë shpejt, përjashton ose paralizon procedurën e hetimit parlamentar. Shumica e shteteve anëtare konsideron që të dy llojet e procedurave janë krejtësisht të pavarura. Për këtë ata bazohen mbi faktin se një komision hetimor parlamentar ngarkohet vetëm për të bërë vlerësimin politik të fakteve të inkriminuara, ndërsa procedura gjyqësore hapet vetëm mbi bazën e një vlerësimi juridik. Sipas parimit të ndarjes së pushteteve, në lojë futen dy degë tërësisht të ndryshme të autoritetit publik. As komisionet hetimore, as gjykatat, që nga ky çast, nuk janë të lidhura me vlerësimin e palës tjetër.

Përkundrazi, sipas ligjit francez, komisionet hetimore nuk mund të trajtojnë probleme që përbëjnë objekt të hetimit gjyqësor ose që janë të pazgjidhura nga gjykata. Hapja e procedurës gjyqësore shënon fundin e misionit të komisionit ekzistues. Megjithatë, në praktikën parlamentare franceze, kjo dispozitë strikte është zbutur paksa me qëllimin për të shmangur një paralizë të punimeve hetimore. Në Irlandë, në rast të një objekti identik

hetimi, vërehet, gjithashtu, një zbutje e parimit të krijimit të komisionit hetimor paralelisht me procedurën gjyqësore. Njohja e përjashtimeve sjell në praktikë këtë ndalim.

dh. Kompetencat

Pothuaj në të gjitha shtetet anëtare, komisionet hetimore janë të pajisura me pushtete të njëjta me ato të hetuesve ose të gjykatësve të ngarkuar në procedurat penale përsa i përket marrjes së provave. Disa parashikime proceduriale janë identike. Në veçanti, komisionet hetimore gëzojnë, në të gjitha këto shtete, të drejtën e thirrjes së dëshmitarëve, të pranojnë depozitimet e tyre dhe të dëgjojnë mendimin e ekspertëve. Në Francë dhe në vendet e Beneluksit, komisionet kanë të drejtë të pranojnë depozitime të bëra nën hetim. Parimisht, anëtarët e qeverisë dhe funksionarët thirren dhe depozitojnë para komisionit.

Në kuadrin e parimit të bashkëpunimit midis autoriteteve, titullarët e institucioneve, prej të cilave janë funksionarët e thirrur nga komisioni, duhet të lëshojnë autorizim që ata të paraqiten. Përjashtimi i vetëm i autorizuar është ruajtja e sekretit të çështjes ose ajo për arsye shtetërore. Dëshmitë e rreme përpara komisionit hetimor mund të ndiqen dhe të sanksionohen nga gjykatat. Për më tepër, praktikisht të gjitha shtetet anëtare u njohin komisioneve hetimore të drejtën e kërkesës për lëshimin e çdo dokumenti ose këshillimi të çdo dosjeje, fakte këto që gjykohen të nevojshme për kryerjen e misionit të tyre. Në këtë kuptim, motivi i vetëm i refuzimit që autorizohet është ruajtja e sekretit.

Në shumicën e shteteve anëtare, ekzekutimi nëpërmjet rrugës së detyrimit të vendimeve të marra nga komisioni është në kompetencën e gjykatave. Paraqitja e dëshmitarëve dhe sekuestrimet mund të kërkohen nga komisioni, por në këtë rast ato urdhërohen nga një gjykatës. Leximi i masave të detyrimit ndaj dëshmitarëve për mungesë paraqitjeje ose dëshmie është pjesërisht në kompetencën e komisioneve hetimore (shiko, p.sh., Luksemburgun dhe Hollandën). Vetëm Franca i autorizon komisionet

hetimore të urdhërojnë paraqitjen e dëshmitarëve ose të kryejnë hetime në vend, nën përgjegjësinë e tyre.

Në tërësi, vërehet se në shumicën e shteteve anëtare, të drejtat themelore të personave mund të preken vetem nga kontrolli gjyqësor. Në këtë fushë, komisionet hetimore duhet të sigurojnë ndihmën e gjykatave dhe të motivojnë qartë domosdoshmërinë e detyrimit. Kjo gjë përbën, gjithashtu, një garanci shtesë për respektimin e të drejtave të personave të akuzuar.

#### e. Përfundimet

Në të gjitha shtetet anëtare, misioni i komisioneve hetimore merr fund me paraqitjen e raportit përfundimtar, i cili bën të njohura faktet e mbledhura nga hetimi dhe vlerësimin e komisionit lidhur me objektin e hetimit. Në Gjermani merren, gjithashtu, parasysh pikëpamjet divergjente në mendimin e përgjithshëm. Në raportin përfundimtar komisioni mund të formulojë rekomandime korrigjuese. Raporti përfundimtar vihet më pas në rendin e ditës për shqyrtim në seancat plenare të asamblesë në fjalë. Zbatimi i masave të propozuara në raportin përfundimtar është e vetmja kompetencë e parlamentit.

Raporti përfundimtar i komisionit hetimor nuk ka rrjedhoja gjyqësore, por ai mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në nivelin politik. Kjo lidhet me faktin se raportet përfundimtare në përgjithësi botohen dhe se parlamenti, nën efektin e presionit politik, duhet të marrë masa konkrete që anojnë nga rekomandimet e raportit. Madje, Holanda bën një hap më shumë, duke autorizuar botimin e të gjitha dosjeve të hetimit. Megjithatë, ashtu si dhe në Portugali, bëhet shumë kujdes për ruajtjen e sekretit. Me anën e këtij efekti politik, komisionet hetimore shfaqen si një instrument kontrolli parlamentar i frytshëm. Në Belgjikë është gjithashtu e mundur që raporti përfundimtar i komisionit t'u transmetohet drejtpërsëdrejti gjykatave, të cilat përcaktojnë vazhdimin gjyqësor ndaj raportit. Tërësia e kësaj procedure garanton që përfundimet e komisionit të sjellin efekte në pjesën më të madhe të tyre.

Me gjithë disa ndryshime në nivelin e procedurave, duket se të gjitha shtete anëtare, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar, u lejojnë komisioneve hetimore parlamentare që të japin një informacion të plotë mbi faktet e referuara, me qëllim për të kontrolluar qeverinë ose pushtetin ekzekutiv.

### **Përvoja shqiptare**

Komisionet parlamentare të hetimit në jetën institucionale shqiptare, në radhë të parë kanë bazë kushtetuese. Në nenin 77 të Kushtetutës përcaktohet se *“Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtareve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.”*.

Në Rregulloren e Kuvendit, miratuar me vendimin nr.357, datë 9.4.1998, ndryshuar me vendimin nr. 399, datë 4.2.1999, komisionet e hetimit rregullohen nga neni 164 dhe 165. Në këto dy nene, përveç parimeve të përcaktuara nga Kushtetuta, vendoset rregulli se në përberjen e komisionit të hetimit përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare në përpjesëtim me numrin që zënë ato në Kuvend. Gjithashtu, parashikohet se detyrat, numri, përbërja dhe afati i veprimtarisë së komisionit të hetimit përcaktohen në vendimin e Kuvendit për krijimin e tij.

Në praktikën e Kuvendit njihet dhe rasti i rregullimit me ligj të veprimtarisë së Komisionit të Hetimit i ngritur për një çështje të veçantë. Ligji nr.8254, datë 12.11.1997 rregulloi veprimtarinë e “Komisionit Parlamentar të Hetimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri në periudhën janar-qershor të vitit 1997”. Me depozitimin e Relacionit Përfundimtar dhe marrjen e vendimit përkatës të Kuvendit, Komisioni pushoi së qeni dhe, për rrjedhojë, ligji i përmendur më sipër është “pa jetë”.

Në parim, bazuar dhe në përvojën e vendeve të Bashkimit Europian, mendojmë se është e rëndësishme të nxjerrim në pah disa elemente kryesore që duhen pasur parasysh në hartimin e ligjit që do të rregullojë hetimet parlamentare:

1. Kushtetuta parashikon dy procedura për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare. Së pari, parashikohet që Kuvendi ka të drejtë të ngrejë një komision të tillë pa parashikuar një procedurë të veçantë. Në këtë rast mund të zbatohet procedura e zakonshme e Kuvendit për vënien në lëvizje të tij dhe marrjen e një vendimi ose projektligji në fjalë mund të bëjë një parashikim të ndryshëm. Së dyti, në rastin kur kërkohet nga  $\frac{1}{4}$  e të gjithë deputetëve, Kuvendi është i detyruar ta ngrejë një komision të tillë dhe nuk është e nevojshme të merret një vendim. Krijimi i komisionit me "votë të minorancës", siç mund të quhet, përbën një "avancim" demokratik të Kushtetutës në këtë drejtim.

2. Në nenin 77/2 të Kushtetutës nuk përcaktohet fusha e veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, por parashikohet që këto mund të ngrihen "për të shqyrtuar një çështje të veçantë". Vlerësimi në këtë rast është i hapur dhe i lihet Kuvendit ose  $\frac{1}{4}$  së deputetëve për ta çmuar nëse është i nevojshëm të ngrihet një komision hetimor parlamentar. Projektligji, duke mos kufizuar hapësirën, mund të specifikojë disa fusha ose çështje në mënyrë të veçantë, për të cilat mund të ngrihet një komision i tillë. Një rast i veçantë mund të ishte procedura e "impeachment-it" për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, por që kërkon një vlerësim të mëtejshëm.

3. Në Kushtetutë nuk përcaktohen kompetencat që do të kenë komisionet hetimore parlamentare. Kushtetutat e disa vendeve në Europë, siç u përmend më lart<sup>3</sup>, parashikojnë që komisionet hetimore parlamentare kanë kompetencat proceduriale të organit të akuzës përsa i përket mbledhjes

3. Shih nenin 82 të Kushtetutës Italiane dhe nenin 44 të Ligjit Themeltar të Gjermanisë.

së provave. Nga studimi i përvojave në vendet e Bashkimit Europian, pothuajse në të gjitha këto shtete, pavarësisht nga parashikimi ose jo në Kushtetutë, komisioneve hetimore parlamentare u njihen kompetenca procedurale si organet e ndjekjes penale lidhur me mbledhjen e provave. Duhet theksuar se pavarësisht se komisioni i hetimit vepron si organi i ndjekjes penale (prokuroria) për mbledhjen e provave, komisioni nuk është organ akuze dhe nuk mund të flasim për marrje ose dublim kompetencash. Nga sa u parashtrua, pavarësisht se në Kushtetutë nuk është parashikuar që komisioni i hetimit të ketë kompetenca procedurale penale për mbledhjen e provave, një parashikim i tillë mund të bëhet nga ligji.

4. Një element i rëndësishëm i hetimeve parlamentare është raporti ndërmjet përfundimeve të këtyre të fundit me procedimet penale të bëra nga prokuroria dhe gjykata. Kushtetuta përcakton se “përfundimet e komisionit hetimor nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t’i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.”.

5. Mendojmë se ligji duhet të rregullojë në mënyrë të veçantë bashkëpunimin institucional të komisionit të hetimit me autoritetet gjyqësore dhe prokurorinë, sidomos për sa i përket rasteve që lidhen me respektimin e të drejtave themelore të shtetasve.

Hartimi dhe miratimi i një ligji, që rregullon sipas parimeve kushtetuese dhe në mënyrë funksionale komisionet e hetimit parlamentar, përbën hapin e parë institucional dhe garancinë për një përdorim të drejtë dhe efektiv të këtij instrumenti të kontrollit parlamentar.

# Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

*Nga Filip Lako*

*Kjo rubrikë synon dhënien e një informacioni mbi legjislacionin e miratuar rishtazi, duke patur parasysh se njohja fillestare e legjislacionit përbën një nga elementet vitale të një shoqërie demokratike. Lidhja midis qytetarëve dhe qeverisë së tyre është e fortë vetëm atëhere kur shqetësimet e tyre, pra, të publikut pasqyrohen në legjislacionin përkatës. Qytetarët që e konsiderojnë qeverinë e tyre si legjitime, ka më shumë të ngjarë që t'i binden edhe ligjeve të saj. Në të njëjtën kohë, synohet t'i vihet në ndihmë subjekteve publike dhe private që “konsumojnë” ligje për një kuptim të shpejtë dhe objektiv të legjislacionit të miratuara rishtazi në Kuvend.*

**Ligj nr.8728, datë 18.1.2001 “Për një ndryshim në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999 dhe me ligjin nr.8606, datë 27.4.2001.** Në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999 dhe me ligjin nr.8606, datë 27.4.2000, neni 15 shfuqizohet. Neni i shfuqizuar bënte fjalë për detyrimin e shoqërive të sigurimeve motorike për të krijuar Byronë Motorike për t'i përfaqësuar këto shoqëri në tregun e brendshëm dhe në vendet e huaja. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.2.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.1 të vitit 2001, faqe 5.

**Ligji nr.8729, datë 18.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”.** Ligji i lartpërmendur bën shtesa e ndryshime që prekin në fakt dekretin nr.295, datë 15.9.1992, i cili është miratuar me ndryshime me ligjin nr.7641, datë 1.12.1992. Shtesat e ndryshimet e bëra me ligjin nr.8729, datë 18.1.2001 kanë të bëjnë kryesisht me Byronë Shqiptare të Sigurimit, si për statusin e saj, për përgjegjësinë e çdo anëtari të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për masën e kontributit, për organet drejtuese etj. Ligji ka 11 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.2.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.1 të vitit 2001, faqe 5.

**Ligji nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”.** Ky ligj përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, kriteret që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen përmbarues gjyqësorë, statusin dhe procedimin disiplinor të përmbaruesit gjyqësor, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private. Përveç sa u tha më sipër, ai urdhëron që riorganizimi i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me rregullat e caktuara në këtë ligj duhet të përfundojë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij. Ligji ka 38 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.2.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.1 të vitit 2001, faqe 10.

**Ligj nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”.** Rregullat për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, përpunimin dhe tregtimin e materialit mbjellës bimor në territorin e Republikës së Shqipërisë përcaktohen me ligjin e lartpërmendur. Gjithashtu, ky ligj përcakton edhe procedurat e kontrollit dhe të vlerësimit cilësor të materialit mbjellës bimor,



kundërvajtjet administrative, ndëshkimet që jepen për kundërvajtjet, organet që kanë të drejtë të vendosin masa administrative, si dhe procedurat e anulimit dhe të ekzekutimit të masave administrative. Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet ligji nr.7659, datë 12.1.1993 “Për farat dhe fidanët”, si dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me të. Ligji ka 19 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 2001, faqe 95.

**Ligj nr.8733, datë 24.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.** Miratimi i Kushtetutës së re diktoi nevojën e ndryshimeve dhe përmirësimeve të mëtejshme të Kodit Penal, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 1995. Pra, ndryshimet dhe përmirësimet kanë të bëjnë sidomos me harmonizimin e Kodit Penal me këtë Kushtetutë. Në pjesën e përgjithshme janë shtuar dispozita të reja për burimet dhe bazat e legjislacionit penal, detyrat e tij, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pronës, rendit juridik, mjedisit, si dhe mbrojtja e rendit kushtetues nga veprat penale. Në pjesën e posaçme, në kuadrin e forcimit të luftës kundër krimit, janë shtuar rrethanat cilësuese. Ndryshime e plotësime të rëndësishme janë bërë në dispozitat që parashikojnë veprat penale kundër trafikëve të paligjshme, të rrëmbimit të personit e sidomos të fëmijëve etj. Është shtuar masa e gjobës për krime e kundërvajtje penale, për të rritur edhe efektin e këtyre dënimeve, si dhe është formuluar më mirë dhe janë vënë kërkesa më rigorozë për lirimin me kusht. Janë shtuar dispozita të reja për parandalimin e skemave piramidale, për asgjësimin dhe vjedhjen e dokumenteve të arkivit e të bibliotekave, për zhdukjen ose humbjen e dosjeve hetimore e gjyqësore etj. Ligji ka 81 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 2001, faqe 100.

**Ligj nr.8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës, të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”.** Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë garantimin e sigurisë së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga rreziku elektrik. Kështu ai tregon për mënyrën e bërjes së kontrollit teknik, për detyrimet e punëdhënësit, informimin e punëmarrësve etj. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij mbikëqyren nga Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (IPIE). Ky ligj përcakton edhe statusin e IPIE-së, detyrat dhe të drejtat e saj, burimet financiare etj. Po ashtu përcaktohen se cilat shkelle përbëjnë kundravajtje, masën e gjobës dhe ekzekutimin e saj. Pra, në tërësi synohet që fusha e veprimtarisë së tij të përputhet me atë të vendeve të BE-së. Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet dekreti nr.3503, datë 7.5.1962 “Mbi Inspektoratin Shtetëror të Sigurimit Teknik për Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me të. Ligji ka 20 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 2001, faqe 117.

**Ligj nr.8735, datë 1.2.2001 “Për një shtesë në ligjin nr.8662, datë 18.9.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”.** Në nenin 1 të ligjit nr.8662, datë 18.9.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” përcaktohet se faturë e konsumit të energjisë elektrike është titull ekzekutiv, por nuk përcaktohet se nga cili organ duhet të ekzekutohet. Prandaj me ligjin 8735, datë 1.2.2001 në nenin 1, pas fjalëve “është titull ekzekutiv”, shtohen fjalët “dhe ngarkohen zyrat e përmbarimit me ekzekutimin e tyre”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.3 të vitit 2001, faqe 88.

**Ligj nr.8736, datë 1.2.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, ndryshuar me ligjin**

**nr.8605, datë 20.4.2000**". Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" janë bërë ndryshime me ligjin nr.8605, datë 20.4.2000 në nenet 60, 61 e 69 dhe janë shfuqizuar nenet 63, 65 e 68. Ndryshimet kanë të bëjnë me shkeljet, konstatimin dhe dënimin e tyre dhe procedurat që ndiqen në këto raste. Edhe me ligjin nr.8736, datë 1.2.2001, pas nenit 64 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 shtohet neni 64/1 që ka të bëjë me masën e gjobës të dënimit për kundërvajtësit dhe ndryshimi në nenin 61 të po atij ligji, gjithashtu ka të bëjë me shtesën e masës së gjobës. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 2001, faqe 123.

**Ligj nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"**. Me këtë ligj përcaktohen rregulla për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, për kushtet që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen prokurorë, për statusin e tyre, për karrierën dhe procedimin disiplinor, si dhe për marrëdhëniet e Prokurorisë me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun. Gjithashtu, ligji përcakton strukturën e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, detyrat e Këshillit të Prokurorisë, strukturën e Prokurorisë pranë sistemit gjyqësor, emërimin dhe procedimin disiplinor të Prokurorisë, statusin dhe karrierën e tyre, si dhe marrëdhëniet e Prokurorisë me institucionet e tjera. Ligji ka 60 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.5 të vitit 2001.

**Ligj nr.8738, datë 12.2.2001 "Për një shtesë në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"**. Neni 121 i Kodit Rrugor vendos rregulla për autoshkollat në lidhje me licencimin, funksionimin, pajisjen e përshtatshme teknike e didaktike të tyre. Pika 5 e nenit 121 të Kodit Rrugor përcakton në mënyrë taksative se kush mundet të marrë licencë për autoshkollë. Me ligjin nr.8738, datë 12.2.2001 bëhet një

shtesë në pikën 5 të nenit 121 të Kodit Rrugor, pse siç u tha më lart, në pikën që përcakton rastet e dhënies së licencës, me këtë shtesë kanë të drejtë të marrin licencë edhe ata persona që kanë punuar në ndërmarrjet dhe sektorët e transportit për më shumë se pesë vjet ose që ka qenë drejtues autoshkolle mbi pesë vjet. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, faqe 169.

**Ligj nr.8739, datë 12.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion”.** Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë garantimin e sigurisë së njerëzve, kafshëve shtëpiake ose vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion. Fusha e zbatimit të ligjit synon që të përputhet me ato të KE-së. Gjithashtu, garantimi i sigurisë së pajisjeve nën presion bëhet nëpërmjet përputhjes me kërkesat thelbësore të sigurisë, sipas rregulloreve që zbatojnë udhëzimet e KE-së. Ligji bën fjalë në mënyrë të qartë për kërkesat thelbësore të sigurisë së pajisjeve nën presion, për përdorimin e pajisjeve nën presion, për Inspektoratin e Pajisjeve nën Presion (IPNP), si dhe për kundërvajtjet. Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet dekreti nr.2170, datë 5.12.1955 “Për Inspektoratin Shtetëror të Pajisjeve nën Presion”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë ligj. Ligji ka 20 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2001, faqe 169.

**Ligj nr.8740, datë 15.2.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelktuale (OBPI-së) “Për interpretimet, ekzekutimet dhe fonogramet””.** Traktati i OBPI-së “Për interpretimet, ekzekutimet dhe fonogramet (TOIEF) e vitit 1996 përmban edhe Konventën e Romës të vitit 1961 dhe Konventën e Bernës të vitit 1971 që përmenden në Traktat. Traktati përmban parashikime të përgjithshme, bën fjalë për të drejtat e artistëve interpretues ose ekzekutues,

për të drejtat e prodhuesve të fonogrameve dhe në fund përmban dispozita administrative. Pjesë të këtij Traktati janë edhe dispozita të Konventës së Bernës për mbrojtjen e punëve letrare dhe artistike të cilave u referohet traktati i mbrojtjes së interpretimit, ekzekutimit dhe fonogrameve, si dhe dispozitat e Konventës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Ekzekutuesve, Interpretuesve, Prodhuesve të Fonogramave dhe Organizmave të Radiopërhapjes (Konventa e Romës (1961) që i referohet WPPT. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2001, faqe 176.

**Ligj nr.8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”.** Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë punën me një regjim normal dhe brenda kushteve të lejuara për jetën e njeriut në veprimtarinë për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe të vlerave materiale në raste avarie dhe kthimin në regjim normal të punës në veprimtarinë minerare. Me këtë ligj, Qeveria Shqiptare, përveç marrjes së detyrimit për mbrojtjen e shtetasve të saj dhe të huaj, të cilët punojnë në sektorin minerar, njëkohësisht plotëson edhe detyrimet ndaj konventave ndërkombëtare dhe parimeve të KE-së për sigurinë në punë. Gjithashtu, ai plotëson më tej kuadrin ligjor në veprimtarinë minerare dhe njëkohësisht krijon mundësi më të mira për forcimin e kontrollit të shtetit në këtë sektor. Ligji ka 22 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2001, faqe 190.

**Ligj nr.8742, datë 15.2.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit (IDB) për projektin e infrastrukturës rurale”.** Kjo marrëveshje u nënshkrua më 8.11.2000 midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit dhe u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 15.2.2001. Huaja ka për qëllim të përmirësojë

kushtet socialekonomike të njerëzve në 36 nga 37 rrethe të Shqipërisë (domethënë 270 nga 400 komuna), të cilat radhiten si më të prekurat nga numri më i madh i familjeve të varfra nga mbështetja sociale e shtetit. Rreth 500 000 familje do të përfitojnë nga huaja e cila do të përdoret për rrugët rurale, ujësjellës, shkolla fillore, zyra administrative të komunave e shërbime konsulente. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2001, faqe 196. Bashkëlidhur botohet edhe marrëveshja e huasë.

**Ligj nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.**

Ky ligj përcakton regjimin juridik të llojeve të pronave të paluajtshme të shtetit dhe përgjegjësitë për administrimin e tyre, bën ndarjen e pronave të paluajtshme publike dhe pronave të paluajtshme jopublike të shtetit. Gjithashtu, ligji rregullon regjistrimin e pronave të paluajtshme, regjistrimin e kushteve dhe kufizimeve, si dhe heqjen ose ndryshimin e tyre. Përveç përcaktimit të pronësisë, ligji bën fjalë edhe për transformimin dhe regjistrimin përfundimtar të pronave, për administrimin dhe parimet e administrimit të pronës së paluajtshme etj. Nëntëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton procedurat për kontestimet e mundshme, lidhur me përgjegjësitë e administrimit për pronat e paluajtshme në përputhje me këtë ligj. Ligji ka 20 nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.4.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.9 të vitit 2001, faqe 255.

**Ligj nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.**Ky ligj rregullon procesin e transformimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetëtare nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në këtë ligj përcaktohen llojet që do t’u transferohen njësitë të qeverisjes vendore, natyra e të drejtave të njësitë të qeverisjes vendore mbi

to dhe procesi, sipas të cilit do të bëhet transferimi i pronave. Transferimi i këtyre pronave të paluajtshme do të shoqërohet edhe me transferimin e pronave të luajtshme që janë të lidhura me pronën e paluajtshme, po kështu dhe gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me këtë pronë. Janë parashikuar edhe procedurat e kontrollit që Këshilli i Ministrave ushtron mbi këto prona me qëllim që ato të mos humbin destinacionin e tyre. Ligji është një hap më tej në drejtim të procesit të decentralizimit, duke rritur përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e njësisve të qeverisjes vendore. Ai përmban 23 nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.4.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.9 të vitit 2001, faqe 259.

**Ligj nr.8745, datë 22.2.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8168, datë 5.12.1996”.** Ndryshimet dhe shtesat që i bëhen ligjit ekzistues me ligjin nr.8745, datë 22.2.2001 mund të paraqiten në tri grupime të mëdha:

- ndryshime për shkak të lëshimit nga Banka e Shqipërisë të kompetencës për ngritjen dhe mbajtjen e një tregu letrash me vlerë;
- ndryshime e shtesa për shkak të plotësimit të aspekteve të parregulluara deri tani me dispozita ligjore.

Për këtë qëllim është zgjeruar dispozita që trajton konfidencialitetin e të dhënave të zotëruara nga komisioni. Shtesa synon përcaktimin e rasteve përjashtimore në të cilat të dhënat mund të jepen kur kjo bëhet mbi bazën e një marrëveshjeje me institucionet e tjera rregullatore ose kur dhënia e tyre përbën detyrim ligjor;

- ndryshime e plotësime, të cilat kanë të domosdoshme, për shkak të përkthimit të gabuar dhe problematik të ligjit ekzistues, si dhe të përshtatjes së terminologjisë me atë të përdorur në rregulloret e miratuara.

Ligji ka 37 nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.3.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.6 të vitit 2001, faqe 157.

**Ligj nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”.**

Me këtë ligj miratohen kufijtë dhe përbërja e zonave zgjedhore sipas tabelës së raportit përfundimtar të Komisionit të Caktimit të Kufijve të Zonave Zgjedhore. Ligjti i janë bashkëlidhur hartat e qarqeve dhe tabela për çdo qark me zonat zgjedhore dhe përbërjen e këtyre zonave. Për çdo zonë jepen lagjet ose fshatrat, si dhe numri i zgjedhësve, si dhe diferencat nga mesatarja. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi ditën e shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8 të vitit 2001, faqe 217.

**Ligj nr.8747, datë 28.2.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit për projektin e lehtësimit të transportit dhe të tregtisë në rajonin e Europës Juglindore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)””.**

Marrëveshja e kredisë së zhvillimit (Projekti i lehtësimit të tregtisë dhe transportit në Europën Juglindore) midis Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim është lidhur më datën 29 nëntor 2000 me numër kredie 3427 ALB. Marrëveshja, e cila i bashkëlidhet ligjit përmban kushtet e përgjithshme, përkufizimet, zbatimin e projektit, klauzolat financiare etj. Po ashtu asaj i lidhet shtojca nr.1 dhe Aneksët A,B me planigrafikët përkatëse. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.4.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, faqe 266.



# Dokumentacioni ligjor mbi luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar

*Përgatiti Elira Zaka*

## A. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE

Instrumentet ndërkombëtare kryesore që lidhen me terrorizmin (me ratifikimin e tyre të 17 shtatorit 2001) janë, si më poshtë:

Konventa e vitit 1963 mbi Veprat Penale dhe Akte të tjera të Kryera në Bordin e një Avioni, ku janë palë 171 shtete; i autorizon komandantit të avionit të vendosë masa të arsyeshme ndaj ndonjë personi që kryen ose ka ndërmend të kryejë akte të kësaj natyre dhe i kërkon shteteve palë të marrin masën e ndalimit ndaj atyre që kryejnë vepra penale.

Konventa e vitit 1970 mbi Ndalimin e Pushtimit të Paligjshëm të Avionit; ku janë palë 174 shtete; kërkon që palët të ndërkombëtare piraterinë ajrore me “dënime të rënda”, si dhe të ekstradojnë ose të ndjekin penalisht ata që kryejnë vepra penale.

Konventa e vitit 1971 për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, ku janë palë 175 shtete, kërkon që palët të ndërkombëtare veprat penale me “dënime të rënda”, si dhe të ekstradojnë ose të procedojnë ata që kryejnë vepra penale; shtuar nga

Protokolli i vitit 1988 për Ndalimin e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, Montreal; ku janë palë 107 shtete, zgjeron dispozitat e Konventës për kufizimin a akteve terroriste në aeroporte.

Konventa e vitit 1973 mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave në Mbrojtje Ndërkombëtare, përfshirë agjentët diplomatikë; ku janë palë 107 shtete, u kërkon palëve të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë sulmet kundër zyrtarëve dhe përfaqësuesve shtetërorë.

Konventa e vitit 1979 Kundër Marrjes së Pengjeve; ku janë palë 96 shtete; palët bien dakort mbi dënimin e aktit të marrjes peng me dënime të përshtatshme, për ndalimin e disa aktiviteteve brenda territorit të tyre; shkëmbimin e informacionit; si dhe kryerjen e procedurave për ndjekje penale ose ekstraduese.

Konventa e vitit 1980 mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore; ku janë palë 68 shtete, detyron palët të sigurojnë mbrojtjen e materialeve bërthamore gjate transportimit brenda territorit të tyre apo në bordet e anijeve apo të avionëve.

Konventa e vitit 1988 për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Marinës Detare; ku janë palë 52 shtete; detyron palët si të ekstradojnë, ashtu dhe të procedojnë autorët e veprave penale, të cilët kryejnë akte të paligjshme kundër anijeve, të tilla si pushtimi i anijeve me forcë dhe vendosja e bombave në bordin e anijeve; zhvilluar nga IMO; plotësuar nga

Protokolli i vitit 1988 për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave të Palëvizshme të vendosura në pjesën ranore kontinentale, të tilla si ato që merren me nxjerrjen e naftës dhe të gazit në det.

Konventa e vitit 1991 mbi Vendosjen e Shenjave në Eksplozivët Plastikë për qëllime zbulimi; ku janë palë 67 shtete, kërkojnë të kufizojnë përdorimin e eksplozivëve pa shenja dalluese.

Konventa Ndërkombëtare e vitit 1997 mbi Ndalimin e Terrorizmit me Bomba; ku janë palë 26 shtete palë; kërkon të mohojë ”parajsat e sigurta” për persona të kërkuar për terrorizëm me bomba, duke detyruar çdo shtet palë të procedojë persona të tillë, nëse nuk do t’i ekstradonte ata në një shtet tjetër që ka shpallur një kërkesë ekstardimi.

Konventa Ndërkombëtare e vitit 1999 për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit; ku janë palë katër shtete, detyron shtetet palë si të procedojnë, ashtu edhe të ekstradojnë persona që akuzohen për financime të veprimtarive terroriste; dhe kërkon që bankat të ndërmarrin masa për identifikimin e transaksioneve të dyshimta; do të hyjë në fuqi kur të ratifikohet nga 22 shtete.

Drafti i Konventës së Mirëkuptimit mbi Terrorizmin Ndërkombëtar i 28 gushtit 2000.

Drafti i Konventës mbi Ndalimin e Akteve të Terrorizmit Bërthamor.

## B. INSTRUMENTET RAJONALE

Konventa e vitit 1971 e Organizatës së Shteteve Amerikane (OAS) për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Akteve Terroriste, që marrin formën e krimeve kundër personit dhe grabitja, të cilat janë pranuar në nivel ndërkombëtar.

Konventa Europiane e vitit 1977 mbi Ndalimin e Terrorizmit, ETS 90.

Konventa Rajonale e vitit 1987 Shoqatës së Azisë Jugore për kooperim rajonal mbi ndalimin e terrorizmit.

Konventa Arabe e vitit 1998 për Luftën ndaj Terrorizmit.

Konventa e vitit 1999 e Organizatës së Bashkimit Afrikan (OAU) mbi Parandalimin dhe Luftën ndaj Terrorizmit.

Drafti i Vendimit në kuadrin e Këshillit të Europës mbi luftën kundër terrorizmit, Bruksel, 19 shtator 2001.

### C. INSTRUMENTET RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME EKSTRADIMIN

Traktati Model i Kombeve të Bashkuara i vitit 1990, përshtatur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/116, 14 dhjetor 1990.

Konventa Europiane mbi Ekstradimin, ETS nr.24

Protokolli shtesë i vitit 1975, ETS, Nr. 86

Protokolli i dytë shtesë i vitit 1978, ETS Nr. 98

Skema e Konfederatës për Dorëzimin e të Ndjekurve Penalisht që Arratisen, sipas ndryshimit të bërë më 1990, *Buletini Ligjor i Konfederatës*, 1990, 1036.

Konventa Ndër-Amerikane e vitit 1981 mbi Ekstradimin, Nenet 59-66(që ka hyrë në fuqi më 28 mars 1952).

Konventa e Shengenit e vitit 1990, e cila aplikon Marrëveshjen e Shengenit të 14 qershorit 1985, përfshirë Titullin III, Kreu IV mbi Ekstradimin, Nenet 59-66.

Konventa e vitit 1995 mbi Thjeshtëzimin e Procedurës së Ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Europjan, OJ Nr.C/078, 30 mars 1990, p.1.

Konventa e vitit 1996, që lidhet me Ekstradimin ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit European, OJ No.C/313, 23 tetor 1996, p.11.

# Zgjedhjet parlamentare në Kosovë dhe korniza kushtetuese

*Përgatiti Leon Shestani*

Një tjetër provë e suksesshme e politikës kosovare...një hap inkurajues drejt konsolidimit të fitoreve të arritura deri tani...pjesëmarrje e gjerë e serbëve të Kosovës në zgjedhje... një fitore e re e LDK-së dhe e Ibrahim Rugovës...

Ky ka qenë refreni i kometeteve të shtypit botëror, i analizave të ndryshme, i emisioneve televizive e agjencive të lajmeve. Më e lehtë sesa parashikohej? Çdo të ndodhë më tej?

“Përgjigjja” a parë erdhi nga fitimtarët. Si gjithnjë, me një ngazëllim të ligjshëm, ai që ka tashmë shansin të thirret “President” nga e gjithë bota, pasi deklaroi fitoren bëri një thirrje për njohjen e pavarësisë së Republikës të Kosovës, që disi e zuri në befasi bashkësinë ndërkombëtare.

Befasia nuk qëndronte në atë që bashkësia ndërkombëtare nuk ishte mësuar me një qëndrim të tillë, por sepse çasti i fitores, sidomos në mendjen e diplomacive europiane, kërkonte një qëndrim më të baraspeshuar dhe të impostuar drejt ndërtimit të institucioneve dhe qeverisjes së ardhshme brenda kuadrit të kornizës kushtetuese.

BE-ja përshendeti menjëherë suksesin e zgjedhjeve në Kosovë, mënyrën e paqtë dhe të qetë me të cilën u zhvilluan këto zgjedhje, si dhe pjesëmarrjen e konsiderueshme të serbëve në këto zgjedhje. BE-ja, duke parashikuar vështirësitë që e presin të ardhmen politike të Kosovës, “hodhi poshtë” deklaratimet e udhëheqësit shqiptar, të moderuarit, Ibrahim Rogova.

Korniza kushtetuese, e cila nuk është e pandryshueshme, pasi mund të

përmirësohet me 2/3 dhe me vendimin e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm ose me nismën e këtij të fundit, nuk mund të dalë jashtë “kufijve” të rezolutës 1244 (1999). Kjo kornizë, si dhe vetë veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit të Kosovës nuk kanë ndonjë kompetencë lidhur me statusin. Le të kujtojmë kreun 12 lidhur me kompetencat e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm: *“Ushtrimi i përgjegjësive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes nën këtë kornizë kushtetuese nuk ndikon ose nuk e zvogëlon autoritetin e PSSP-së në sigurimin e zbatimit të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë mbikëqyrjen e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, mbikëqyrjen e zyrtarëve dhe organizmave të tyre dhe marrjen e masave të duhura kurdo që veprimet e tyre janë të papajtueshme me Rezolutën 1244 (1999) ose me këtë kornizë kushtetuese.”*

Po kështu, lidhur, me kompetencat e KFOR-it, në këtë kornizë kushtetuese thuhet se *“Asgjë në këtë kornizë kushtetuese nuk ndikon mbi kompetencat e Pranisë Ndërkombëtare të Sigurisë (PNS) në plotësimin e të gjitha aspekteve të saj nën Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjes Ushtarako-Teknike (Marrëveshja e Kumanovës).”* Ndërkaq, kompetencat në qeverisje janë më të plota, sidoqë përsa i përket nismës ligjore, roli i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) mbetet i ngjashëm me atë të një dhome të lartë me të drejtë vetoje, që kur do është president dhe kur do është gjykatë kushtetuese, si dhe në raste të veçanta mund të jetë edhe parlament.

Presidenti i Kosovës ka një rol tejet të kufizuar. Në linja të trasha:

- Kryetari i Kosovës përfaqëson unitetin e popullit dhe garanton funksionimin demokratik të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes.
- Kryetari i Kosovës, në bashkërendim me PSSP-në përfaqëson Kosovën, ushtron të drejtat dhe detyrat e tij në pajtim me dispozitat e kësaj kornize kushtetuese dhe me ligjin e zbatueshëm.
- Mandati i kryetarit të Kosovës zgjat tre vjet.

- Kryetari i Kosovës, duke u mbështetur në këtë kornizë kushtetuese dhe në ligjin e zbatueshëm, ushtron këto funksione:

(a) në bashkërendim me PSSP-në merr masa në fushën e bashkëpunimit me jashtë;

(b) pas këshillimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, i propozon Kuvendit Kryeministrin e Qeverisë;

(c) i dorëzon PSSP-së kërkesën e Kuvendit për shpërndarjen e Kuvendit në pajtim me paragrafin 8.1 (b) të kornizës kushtetuese;

(ç) të paktën njëherë në vit i paraqet një raport Kuvendit të Kosovës për gjendjen e përgjithshme në Kosovë dhe;

(d) jep medalje dhe shpreh mirënjohje.

Me 10 dhjetor, Kuvendi i ri i zgjidhur i Kosovës do të mbajë mbledhjen e tij të parë. Kjo do të përbëjë një ngjarje tjetër të shënuar për Kosovën, ligjvënësit e përfaqësuesit politikë të së cilës janë tashmë të thirrur në “skenë” për të provuar se janë të aftë dhe në gjendje të hapin rrugët e zhvillimit e prosperitetit të Kosovës.

Argumentet më të fuqishme propavëresi do të jenë: aftësia e ndërtimit të institucioneve, qeverisja efiçente, toleranca ndëretnike, zhvillimi i shoqërisë civile, prosperiteti ekonomik dhe hapja e rrugëve për integrimin euroatlantik, gjë të cilën e aspirojnë të gjithë kosovarët.



# Veprimtari te Qendrës Studimore mbi Praktikat Parlamentare dhe Demokratike

*Elira ZAKA*  
*Koordinatorë QSPPD*

Qendra Studimore mbi Praktikat Parlamentare dhe Demokratike ka zgjeruar në mënyrë të dukshme gamën e aktiviteteve të saj, duke synuar në një pjesëmarrje dhe prani të saj jo vetëm në veprimtari brenda vendit në shërbim të zhvillimit të demokracisë, në përgjithësi, dhe parlamentit në veçanti, por edhe në ato në nivel rajonal që i shërbejnë këtij synimi.

Një aktivitet i kësaj natyre u zhvillua më datat 9 – 10 nëntor 2001 në Tiranë.

I. Seminari me titull “Rëndësia e mbikqyrjes legjislative” u organizua nga Qendra për Studime të Sigurimit European (CEES) dhe Qendra Studimore mbi Praktikat Parlamentare dhe Demokratike (QSPPD).

Ky aktivitet zhvillohej në kuadrin e programit të DEMCON-SEE, mbi Kontrollin Demokratik: Programi për Edukimin e Stafit Parlamentar dhe Parlamentit, i hartuar prej Qendrës për Studime të Sigurimit European (CESS), me synim nxitjen e mbikqyrjes legjislative në sektorin e sigurimit në shtatë shtete të Europës Jug-Lindore, ku bëjnë pjesë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Federale e Jugosllavisë, Maqedonia dhe Rumania.

Programi i Kontrollit Demokratik synon pajisjen e parlamentarëve të Europës Jug-Lindore dhe stafit parlamentar të këtyre vendeve me njohuri, aftësi dhe mjete për t’i përgatitur ata në përmbushjen e rolit të tyre si mbikqyrës të qeverive në fushën e sigurimit dhe në rritjen e efektivitetit të tyre në këtë rol.

Qëllimi i kësaj nisme është të kontribuojë në ndërtimin e demokracisë në secilin nga këto vende, duke ju dhënë përfaqësuesve të zgjedhur njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ushtruar një mbikqyrje efektive. Programi synon të kontribuojë, gjithashtu, në ndërtimin e demokracisë në gjithë rajonin, duke lehtësuar shkëmbimet e përvojave midis legjislativave ose institucioneve të tjera në sektorin e çështjeve të sigurimit.

Ky projekt u mundësuar nga Tryeza e Punës I e Paktit të Stabilitetit për Europën Jug-Lindore. Ajo i përket paketës “Nisje e shpejtë”, në Paktin e vitit 2000, seksioni i propozimeve për punën me parlamentarët.

Në seminar pati një pjesëmarrje të gjerë nga deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, personalitete në fushën e Mbrojtjes, staf i parlamentit, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit. Parlamentarët e ftuar ishin përfaqësues të të gjithë spektrit politik shqiptar. Ata realizuan një debat mjaft konstruktiv mbi rolin e Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, të Rendit e SHISH-it. Gjithashtu, u propozuan një sërë rekomandimesh për përmirësimin e kontrollit parlamentar mbi çështjet e sigurisë. Disa nga temat e trajtuara në seminar ishin: kërkesat e reja të Mbrojtjes dhe Sigurimit si rezultat i kërcënimeve të reja e roli i Parlamentit; çështje të Sigurisë në Europën Jug-Lindore; media, parlamenti dhe qeveria në lidhje me çështje të Mbrojtjes dhe të Sigurimit; vendosja e Ushtrisë nën Kontrollin Demokratik, sfida e Shqipërisë në këtë kuadër; vendosja e Policisë dhe e Forcave të Sigurimit të Brendshëm nën Kontrollin Demokratik; si dhe prioritetet e reformës për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore, në përgjithësi.

***II. Trajnim me administratën vendore në Qarkun e Elbasanit mbi ndërtimin e qeverisjes vendore sipas parimeve të autonomisë vendore.*** Trajnimi u zhvillua në dy faza, përkatësisht, gjate muajve shtator dhe nëntor, 2001.

Nëpërmjet programit të këtij trajnimi synohej zbatimi i parimeve të autonomisë vendore nëpërmjet përmirësimit e rritjes së njohurive dhe të të

kuptuarit të Kartës së Autonomisë Vendore, parimeve të autonomisë lokale dhe decentralizimit të qeverisjes, si dhe unifikimi i praktikës në këtë fushë në këndvështrim ligjor dhe praktik.

U trajnuan rreth 30 pjesëmarrës, nga këta, 15 specialistë në nivele drejtuese të bashkive të Qarkut të Elbasanit, dhe në fazën e dytë 15 kryetarë komunash po në Qarkun e Elbasanit.

Decentralizimi i pushtetit vendor dhe inkurajimi i vete-qeverisjes përbën një nga sfidat më të rëndësishme të reformës institucionale gjatë periudhës së tranzicionit. Objektivat që synohej të arriheshin në përfundim të këtij trajnimi ishin: njohja me parimet themelore të autonomisë së pushtetit vendor, rëndësia e tyre, si të identifikohen ato dhe të përdoren përmes legjislacionit dhe praktikës; identifikimi dhe përdorimi i burimeve të ndryshme kushtetuese dhe ligjore për zbatimin e autonomisë së pushtetit vendor; identifikimi i çështjeve të ndryshme politike nën autoritetin e pushtetit vendor, si dhe strukturimi i tyre, trajtimi i çështjeve të ndryshme ligjore të hasura nga marrëdhëniet me institucione të tjera shtetërore; si të hartojme politika financiare dhe buxhetore efektive; si dhe përpilimi i disa rregullave dhe standardeve.

**III. Trajnim i nëpunësve civilë mbi çështjet e ligjit për azilin në Shqipëri,** i organizuar në bashkëpunim dhe me mbështetjen e UNHCR dhe CRMS. Ky trajnim synonte rritjen e njohurive bazë për çështje të azilit të nëpunësve civilë në strukturat ministrore dhe bashkiake mbi çështje të ligjit të azilit dhe të refugjatëve. Deri tani janë trajnuar rreth 20 vetë, përfaqësues të ministrive përkatëse të përfshira në program, kryesisht specialistë ligjorë dhe drejtues sektorësh, dhe pritet të trajnohen edhe 20 përfaqësues të pushtetit vendor në Tiranë dhe në Korçë.

Trajnimi do të siguronte njohuri të përgjithshme mbi sistemin shqiptar dhe ndërkombëtar të azilit, të kuptuarin e të drejtave ligjore dhe përfitimet sociale të refugjatëve, si dhe një forum diskutimesh mbi strategjinë e zbatuar për sistemin e azilit si dhe programin e integritit lokal në Shqipëri.

Trajnimi u zhvillua në dy pjesë kryesore: e para, u zhvillua në formë diskutimesh mbi dokumentacionin ligjor relevant si dhe bazën teorike/politike mbi të cilin ish krijuar legjislacioni; e dyta, në formën e një debati aktiv dhe diskutime praktike rreth interpretimit dhe zbatimit të këtyre themeleve ligjore në Shqipëri. Nje vëmendje e vecantë në trajnim iu kushtua cështjes së integritetit lokal të të huajve që përfitojnë azil në Shqipëri.

# Discussions in the Parliament of Albania on the fight against terrorism

*Address by deputy  
Dashamir Shehi*

Distinguished Mr. Chairman,  
Distinguished colleagues,

I think that today's debate on terror might have been held earlier, probably one week or 10 days ago. However, I consider it rather a success of this Assembly that, after such a long time it is finally holding a common session with the government about such an important topic, which really needs the contribution and support of all the institutional forces operating in Albania today.

In my view, we should not return again to the fight on terror and its importance, because this is a topic that we have exhausted during the two last weeks during which we have discussed only about it. In my view, we should discuss the role that the political parties, the body politics, the Assembly, and the various institutions should play under the current circumstances.

Unfortunately, right after the 11 September attacks on New York, we saw that given groups, persons, and forces in Albania expressed a strange satisfaction over the fact that Albania was allegedly infected by elements of Islamism. Our opposition [ruling parties] was the first to voice its pleasure, which was due to the fact that another political force was in office before 1996. Therefore it thought that that this allegation would damage

